

- P R O J E K T -

LIGJ

Nr. ----- date-----

**PËR PROCEDURAT TATIMORE
DHE ADMINISTRATEN TATIMORE**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

**KREU I
DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti i Ligjit**

Ky ligj rregullon procedurat për administrimin e tatimeve në Republikën e Shqipërisë si dhe parimet e organizimit dhe të funksionimit të administratës tatimore në Republikën e Shqipërisë.

Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të gjitha llojet e tatimeve dhe taksave, me përjashtim të rasteve kur ligji i veçantë e ka parashikuar ndryshe.

**Neni 2
Fusha e veprimit**

Ky ligj e shtrin veprimin e vet mbi:

- a. tatimpaguesit, administraten tatimore, agjentët tatimorë dhe persona të tjerë të përcaktuar sipas legjislacionit tatimor,;
- b. sistemin e tatimeve dhe taksave qendrore;
- c. sistemin e tatimeve dhe taksave vendore, për aq sa nuk rregullohen me ligjin nr. 9632, date 30.10.2006, “Per sistemin e taksave vendore”.

Legjislacioni tatimor nenkupton:

- a. marreveshjet nderkombetare të ratifikuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë;
- b. ligjet tatimore;
- c. aktet nën ligjore të miratuara në mbështetje të ligjeve tatimore.

**Neni 3
Tatimi, taksa dhe kontributi**

Taksa është pagese e detyrueshme dhe e pakthyeshme ne buxhetin e shtetit apo ne buxhetin e organeve te pushtetit vendor, e vendosur me ligj dhe qe paguhet nga cdo person qe ushtron nje te drejte publike apo perfiton nje sherbim publik ne territorin e republikes se shqiperise.

Tatimi është pagese e detyrueshme dhe e pakthyeshme ne buxhetin e shtetit apo ne buxhetin e organeve te pushtetit vendor, e vendosur me ligj dhe qe buron nga ralizimi i veprimtarive e raporteve tregtare ne raport te drejte me volumin e tyre.

Kontributi është detyrim monetar i detyrueshem per t'u paguar si shperblim per nje sherbim specifik apo ushtrim te te drejtave per sigurimin shoqeror dhe shendetesor te te punësuarve.

Tatimi është kombetar ose vendor.

Tatimet kombetare perfshijne:

- a. tatimi mbi vleren e shtuar;
- b. tatimi mbi te ardhurat;
- c. akciza;
- d. tatimi per lojrat e fatit, kazinote dhe hipodromet;
- e. tatime te tjera te cilat jane percaktuar si te tilla me ligj te veçante.

Tatimet dhe taksat vendore, përcaktohen ne ligjin per sistemin e taksave vendore.

Kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore përcaktohen ne ligjin per sigurimet shoqerore dhe shendetesore.

Neni 4 Tatimpaguesi

Tatimpaguesi është personi apo individi i cili detyrohet nga ligji te paguaje tatime, taksa ose kontribute te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore.

Neni 5 Periudha Tatimore

Me perjashtim te rasteve kur ky ligj ose ligje te tjera tatimore parashikojne ndryshe, periudha tatimore është e njejte me vitin kalendarik.

Neni 6 Detyrimi tatimor

Detyrimi tatimor perfshin tatimin, taksen, apo kontributin e vleresuar, interesat per pagesat e vonuara si dhe gjobat per rastet e parashikuara nga ky ligj.

Tatimi, taksa apo kontributi i vleresuar është shuma e perlllogaritur nga tatimpaguesi ose nga administrata tatimore ne lidhje me tatimet, taksat si dhe kontributet e sigurimeve shoqerore e shendetesore. Detyrimi tatimor lind kur personi realizon te ardhura, kur behet pronar i nje pasurie apo kryen pagesa, te cilat i nënshtrohen legjislacionit tatimor.

Detyrimi tatimor lind edhe kur personi realizon te ardhura, kryen pagesa ne forme te jashteligjshme apo behet pronar i nje sendi ne forma te jashteligjshme. Kur personi behet pronar i nje sendi ne forma te jashteligjshme, ky detyrim perlllogaritet per te gjithë peridhen ne te cilen personi ka gezuar frytet e asaj pasurie.

Neni 7

Agjentit i mbajtjes së tatimit

Agjenti i mbajtjes së tatimit është personi, te cilit i kërkohet të llogarisë, të mbajë tatimin në burim për një tatimpagues, të raportojë si dhe t'i transferojë këto tatime në buxhetin e shtetit.

Me përjashtim të rastit kur ligji e përcakton ndryshe, agjenti i mbajtjes së tatimit ka të njëjtat të drejta dhe detyrime me një tatimpagues.

Agjenti i mbajtjes së tatimit ka detyrat plotësuese si vijon:

- a. të llogarisë saktësisht dhe të mbajë në burim tatimin për një tatimpagues;
- b. të paguajë tatimin në burim në Buxhetin e Shtetit në datën e përcaktuar në ligj;
- c. të mbajë regjistrime për të ardhurat e paguara dhe për tatimet e mbajtura në burim të gjithë tatimpaguesve, dhe të pagesave të transferuara në buxhetin e shtetit;
- d. t'i japë administratës tatimore informacion të saktë për deklaratat e tatimpaguesve në datën e duhur të përcaktuar në ligj si dhe
- e. të kryejë të gjitha detyrat e tjera të parashikuara nga dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 8

Tatimpaguesi rezident dhe jo-rezident

Tatimpagues rezident është:

a. individi i cili:

- i) ka një vendbanim në Republikën e Shqipërisë në kuptim të nenit 12 të Kodit Civil;
- ii) ka nënshtetësi shqiptare dhe është funksionar diplomatik ose i ngjashëm i Republikës së Shqipërisë jashtë territorit të saj; ose
- iii) individi që në mënyrë të vazhdueshme ose me ndërprerje, qëndron në Republikën e Shqipërisë më tepër se 183 ditë në një periudhë tatimore;

b. personi juridik i cili:

- i) është regjistruar si person juridik shqiptar; ose
- ii) ka vendin e administrimit efektiv të veprimtarisë në Republikën e Shqipërisë; si dhe

c. personi fizik, i cili, është regjistruar me këtë cilësi në bazë të legjislacionit shqiptar në organin kompetent.

Vendi i administrimit efektiv të veprimtarisë, përcaktohet me udhëzim të ministrit të financave.

Tatimpaguesi që nuk plotëson të paktën njërin nga parashikimet e paragrafit të parë të këtij neni, është tatimpagues jo-rezident.

Neni 9

Perfaqësuesi tatimor i personave jo-rezidentë

Tatimpaguesi jo-rezident emëron një përfaqësues tatimor.

Tatimpaguesi jo-rezident mund të mos emërojë përfaqësues tatimor në rastet kur:

- a. të gjitha burimet e tij të ardhurave në Shqipëri i nënshtrohen mbajtjes përfundimtare në burim ose

- b. tatimpaguesi nuk i nenshtrohet detyrimit per te dorëzuar deklaratë tatimore.

Neni 10

Negocimi i marrëveshjeve ndërkombëtare

Ministri i financave, me cilesine e autoritetit nenshkrues, hyn në bisedime dhe negociacion, marrëveshjet ndërkombëtare me objekt eliminimin e tatimit të dyfishtë.

Ministri i financave, eshte pale ne negociatat qe zhvillohen per te gjitha marrëveshjet e tjera nderkombetare qe kane efekte tatimore. Autoriteti nënshkrues dhe miratues i këtyre marrëveshjeve vepron në përputhje me ligjin “Për Lidhjen e Marrëveshjeve dhe Traktateve Ndërkombëtare.”

Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve është përgjegjëse për administrimin e të gjitha marrëveshjeve nderkombetare te ratifikuara nga Kuvendi sipas pikes 1 te këtij neni.

KREU II

ORGANIZIMI DHE PERSONELI I ADMINISTRATES TATIMORE

Seksioni I

Organizimi dhe struktura e administrates tatimore

Neni 11

Administrata tatimore

Administrata tatimore përbëhet nga administrata tatimore qendrore dhe administrata tatimore lokale.

Administrata tatimore qendrore perfshin drejtorine e pergjithshme, drejtorite rajonale, si dhe njesite e tjera sipas parashikimit te bere ne strukturen e miratuar nga Kryeministri.

Administrata tatimore lokale, perfshin zyrat e taksave të pushtetit vendor.

Neni 12

Vartesia e administrates tatimore qendrore

Administrata tatimore qendrore eshte institucion qendror ne varesi te ministrit te financave.

Neni 13

Emerimi i drejtorit te pergjithshem te tatimeve, nen/drejtoreve dhe drejtorit te drejtorise se apelimeve

Organ drejtues i administrates tatimore qendrore eshte drejtori i pergjithshem. Drejtori i pergjithshem i tatimeve emerohet nga Kryeministri me propozim te ministrit te financave.

Nen/drejtoret e pergjithshem te tatimeve emrohen nga ministri i financave me propozim te drejtorit te pergjithshem te tatimeve.

Drejtori i drejtorise se apelimit tatimor emrohet nga Ministri i Financave.

Neni 14

Struktura e administrates tatimore qendrore

Struktura dhe numri i pergjithshem i personelit te administrates tatimore, miratohet nga Kryeministri me propozim te ministrit te financave.

Administrata tatimore qendrore perbehet nga:

- drejtoria e pergjithshme;
- drejtoria rajonale tatimore;
- njesi te tjera sipas struktures se miratuar nga Kryeministri.

Organigrama e administrates tatimore qendrore hartohet ne perputhje me kerkesat e nenit 16 te ketij ligji dhe miratohet nga Ministri i Financave me propozim te drejtorit te pergjithshem te tatimeve.

Neni 15

Drejtoria rajonale dhe njesite e ngashme me to

Drejtoria rajonale varet nga drejtori i pergjithshem i tatimeve.

Drejtoria rajonale drejtohet nga drejtori i drejtorise rajonale.

Njesi e ngjashme me drejtorine rajonale eshte njesia brenda struktures se administrates tatimore qendrore, e cila ne perputhje me strukturen dhe me pershkrimin e punes, ka organizim dhe funksion te njejte ose te ngjashem me ate te drejtorise rajonale.

Neni 16

Organizimi funksional i administrates tatimore qendrore

Administrata tatimore qendrore organizohet dhe ushtron veprimrimtarine e saj ne perputhje dhe ne zbatim te funksioneve baze dhe ato mbeshtetese te percaktuara ne kete nen.

Funksionet baze jane:

1. sherbimi ndaj tatimpaguesve dhe rregjistrimit;
2. mbledhja e detyrimeve tatimore;
3. kontrolli tatimore;
4. investigimi tatimor;

Funksionet mbeshtetese jane:

1. financat dhe statistikat tatimore;
2. sherbimi nepermjet sistemit te integruar informatik;
3. kontrolli dhe investigimi i brendshem;
4. sherbimet ligjore;
5. administrata dhe burimet njerezore;
6. interpretimi dhe sqarimi i rregullave tatimore

Neni 17

Drejtoria e sherbimit ndaj tatimpaguesve dhe rregjistrimit

Drejtoria e sherbimit ndaj tatimpaguesve dhe rregjistrimit menaxhon dhe garanton zbatimin e funksionit te sherbimit dhe rregjistrimit ndaj tatimpaguesve ne Drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve, Drejtorine Rajonale dhe Njesite e ngjashme me te. Funksionet dhe detyrat e kesaj drejtorie percaktohen ne rregulloret e brendshme

perkatese te drejtorise se pergjithshem te tatimeve, drejtorise rajonale dhe njesive te ngjashme me to ne perputhje me parashikimet e ketij ligji dhe ligjeve te tjera tatimore.

Neni 18 **Drejtoria e mbledhjes dhe masave shtrënguese**

Drejtoria e mbledhjes dhe masave shtrënguese menaxhon dhe garanton funksionin e mbledhjes se detyrimeve tatimore dhe zbatimin e masave shtrënguese ndaj tatimpaguesve ne drejtorine e pergjithshme te tatimeve, drejtorine rajonale dhe njesite e ngjashme me to. Funksionet e kesaj drejtorie percaktohen ne rregulloret e brendshme te drejtorise se pergjithshme te tatimeve, drejtorise rajonale dhe njesive te ngjashme me to, ne perputhje me parashikimet e ketij ligji dhe ligjeve te tjera tatimore.

Neni 19 **Drejtoria e kontrollit**

Drejtoria e kontrollit menaxhon dhe garanton funksionimin e kontrollit ndaj tatimpaguesve, per te garantuar hartimin dhe perdorimin e sistemeve te qarta te kontrollit te percaktuara ne manualet e kontrollit ne drejtorine e pergjithshme te tatimeve, drejtorine rajonale dhe njesite e ngjashme me to. Funksionet e kesaj drejtorie percaktohen ne rregulloret e brendshme te drejtorise se pergjithshme te tatimeve, drejtorise rajonale dhe njesive te ngjashme me to, ne perputhje me parashikimet e ketij ligji dhe ligjeve te tjera tatimore.

Neni 20 **Departamenti operativ hetimor**

Departamenti operativ hetimor funksionon si njesi e specializuar investiguese dhe zbatuese e legjislacionit tatimor dhe drejtohet nga njeri prej nen/drejtoreve te pergjithshem te tatimeve. Departamenti operativ hetimor perbehet nga:

- 1- drejtoria e inteligjencës;
- 2- drejtoria e investigimit të veprave penale tatimore;
- 3- drejtoria e verifikimit tatimore.

Drejtoria e investigimit te veprave penale gezon atributet e policise gjyqesore ne perputhje me parashikimet e kodit te procedurave penale dhe ligjit per organizimin dhe funksionimin e policise gjyqesore. Marrdheniet e punes se personelit te drejtorise se investigimit te veprave penale jane ne perputhje me ligjin per organizmin e policise gjyqesore.

Personeli i drejtorise se verifikimit tatimore pajiset me uniforme dhe me arme ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Neni 21 **Drejtoria e apelimeve tatimore**

Drejtoria e apelimeve tatimore është pjese e strukturave te drejtorise se pergjithshme te tatimeve.

Drejtori është i ngarkuar për drejtimin teknik, organizativ, financiar dhe të burimeve njerëzore të drejtorisë së apelimeve tatimore.

Kompetencat dhe pershkrimi i punes i drejtorit dhe i kësaj drejtorie, rregullohen nga ky ligj si dhe nga rregulloret e brendshme te miratuara nga drejtori i pergjithshem i tatimeve.

Drejtori i drejtorise se apelimeve tatimore eshte i pavarur ne marrjen e vendimeve ne lidhje me aktet administrative te apelueshme.

Neni 22 **Komisioni disiplinor i tatimeve**

Komisioni disiplinor i tatimeve eshte strukture ad-hoc, perberja dhe procedurat e funksionimit te te cilit percaktohen ne rregulloren e funksionimit te komisionit disiplinor te tatimeve, e miratuar nga drejtori i pergjithshem i tatimeve.

Seksioni III **Nepunesit dhe punonjesit e administrates tatimore**

Neni 23 **Emërimi i personelit**

Nëpunësit drejtues dhe specialistë të administratës tatimore gezojne statusin e nepunesit civil dhe per marrdhenien e punesimit te tyre zbatohet legjislacioni i nëpunësit civil për institucionet e pavarura.

Procedurat e rekrutimit kryhen nga drejtoria e personelit ne drejtorine e pergjithshme te tatimeve.

Marrëdhëniet juridike të punës për punonjësit e Policisë Tatimore dhe për personelin e strukturave mbështetese të administratës tatimore, rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

Neni 24 **Punesimi dhe kategorite e punesimit**

Drejtori i pergjithshem i tatimeve merr masat për respektimin e dispozitave ligjore ne lidhje me rekrutimin e nepunesve dhe punonjesve te tjere në drejtorinë e pergjithshme të tatimeve dhe në drejtorite rajonale.

Në organikë, personeli ndahet sipas detyrave, në punonjës të nivelit të lartë, të mesëm e të ulët drejtues dhe në punonjës ekzekutues të kategorizuar në aktet nënligjore, në zbatim të këtij ligji.

Nivelet e pagave per çdo kategori si dhe procedurat dhe afatet e kalimit nga një nivel me i ulët në një nivel më të lartë karriere, miratohen nga Keshilli i Ministrave me propozim te ministrit te financave.

Neni 25 **Shpërblimet e personelit**

Personelit të administratës tatimore qendrore, i njihen shpërblime stimuluese, sipas kritereve të mëposhtëme:

- a. shërbimi i kryer në organet tatimore;
- b. shërbime me rrezik të veçantë për personin;

c. performanca në punë.

Drejtori i përgjithshëm i tatimeve, miraton funksionet të cilat trajtohen si me rrezik të veçantë për personin e punësuar si shpërblimin e parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni.

Ministri i Financave miraton udhëzimin për rregullat që ndjek drejtori i përgjithshëm në dhenien e shpërblimeve.

Neni 26 **Procedura disiplinore**

Drejtori i përgjithshëm i tatimeve shqyrton rastet e shkeljeve të konstatuara nga nepunësit dhe punonjësit e tjerë të administratës tatimore qendrore dhe miraton masat disiplinore.

Fillimi i procedurave disiplinore bëhet sipas procedurave të parashikuar në këtë nen dhe pas:

- a. kërkeses me shkrim të bëra nga eprorët direkt të nepunësit apo punonjësit të administratës tatimore;
- b. kërkeses me shkrim të bëra nga tatimpaguesi ose
- c. me iniciative të drejtorit të përgjithshëm.

Nëse nepunësit e administratës tatimore qendrore, gjatë ushtrimit të detyres nuk përmbushin kërkesat e këtij ligji ose të ligjeve tatimore, eprori direkt ka të drejtë që brenda 5 ditëve të paraqet ankesën e tij me shkrim drejtorit të përgjithshëm të tatimeve. Bashkë me propozimin e masës disiplinore, drejtori i përgjithshëm i tatimeve brenda 5 ditëve shqyrton dhe merr vendim për miratimin ose jo të propozimit të bëra.

Tatimpaguesi ka të drejtën që brenda 10 ditëve nga konstatimi i shkeljes së pretenduar, të paraqesë ankesën e tij me shkrim pranë drejtorit të përgjithshëm të tatimeve. Drejtori i përgjithshëm i tatimeve, brenda tre ditëve ja kalon kërkesën për shqyrtim komisionit disiplinor të tatimeve. Komisioni disiplinor i tatimeve, brenda 15 ditëve shqyrton ankesën, dhe i propozon drejtorit të përgjithshëm masën disiplinore. Masat disiplinore që zbatohen për nepunësit civil të administratës tatimore janë në përputhje me legjislacionin për shërbimin civil.

KREU III **DETYRAT E ADMINISTRATËS TATIMORE**

Seksioni I **Drejtoria e përgjithshme e tatimeve dhe drejtoria rajonale**

Neni 27 **Detyrat e DPT**

Drejtoria e përgjithshme e tatimeve ka për detyrë:

- a. të ofrojë shërbimet tatimor me cilësi me të lartë duke shfrytëzuar maksimalisht burimet njerëzore dhe materiale dhe me kosto sa më të ulët duke garantuar mbledhjen e tatimeve dhe taksave kombëtare si dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;
- b. të sigurojë zbatim të njëjtë të ligjeve dhe procedurave, lidhur me tatimet dhe të drejtat e tatimpaguesve, dhe të përkrahë të drejtat e tatimpaguesve, të shprehura në këtë ligj;

- c. të hartojë aktet nenligjore në zbatim të legjislacionit tatimor dhe materiale të tjera edukuese dhe informuese që kanë për qëllim asistimin e tatimpaguesve për të përmbushur detyrimet tatimore;
- d. të krijojë një sistem të integruar të bazës së të dhënave, i cili siguron regjistrimin e të gjitha detyrimeve tatimore kombëtare si dhe pagesat nga çdo tatimpagues, duke i klasifikuar sipas kategorive të tatimeve, duke bërë të mundur që ky sistem të jetë i hapur për tatimpaguesit;
- e. të ndërmarrë kontrole dhe hetime të brendshme me objekt analizimin e efikasitetin e administrimit dhe të zbatimit të politikave tatimore, si dhe të propozojë përmirësimin e funksionimit të brendshme të drejtorisë së përgjithshme;
- f. të propozojë përmirësimin e legjislacionit tatimor;
- g. të mbledhë të dhëna mbi tatimpaguesit, t'i analizojë ato si dhe të hartojë raporte lidhur me mbledhjen e të ardhurave tatimore;
- h. të përgatisë parashikimin e të ardhurave të vlerësuara për periudhat e ardhshme duke u bazuar në propozimet e degeve tatimore;
- i. të hetojë shkeljet e mundshme të legjislacionit tatimor;
- j. të mbikëqyrë veprimtarinë e degëve tatimore;
- k. të bashkëpunojë me institucione të tjera fiskale si drejtoria e përgjithshme e doganave dhe zyrat e taksave vendore, në funksion të zbatimit të sistemit tatimor;
- l. të sigurojë edukim profesional dhe trajnim të personelit të drejtorisë së përgjithshme;
- m. të marrë masat e duhura administrative që personeli i drejtorisë së përgjithshme të veprojë në përputhje me kodin e etikës;
- n. të bashkëpunojë me institucione dhe organizma të tjera në kuadër të luftës kundër pastrimit të parave dhe krimit të organizuar;
- o. të kryejë detyra të tjera sipas parashikimeve të bëra nga ligje të veçanta.

Me përjashtim të rasteve kur ligji i vecantë ka parashikuar ndryshe, administrata tatimore nuk vepron në emer dhe për llogari të ndonjë organi apo institucioni tjetër shtetëror dhe nuk ka përgjegjësinë e mbledhjes së detyrimeve që të tretet kanë me këto organe.

Neni 28

Detyrat e drejtorit të përgjithshëm

Drejtori i përgjithshëm ka për detyrë:

- a. të organizojë dhe drejtojë veprimtarinë e administratës tatimore qendrore për të siguruar mbledhjen e tatimeve dhe taksave kombëtare si dhe të kontributeve, në pajtim me legjislacionin tatimor;
- b. të negociojë dhe të nënshkruajë marrëveshjet dypalëshe me objekt bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit;
- c. të miratojë rregulloren e brendshme administrative të administratës tatimore qendrore;
- d. të miratojë rregulloren e përshkrimi të punës të administratës tatimore qendrore;
- e. të miratojë rregullore për kodin e etikës së të punësuarve në administratën tatimore qendrore;
- f. t'i propozojë për miratim ministrit të financave planin e të ardhurave nga tatim-taksat kombëtare dhe pagesën e kontributeve për vitin pasardhës;
- g. detyra të tjera të parashikuar në këtë ligj.

Neni 29

Funksionet e drejtorise të inteligjencës

Drejtoria e inteligjencës ka funksionet e mëposhtme:

- a. mbledh dhe përpunon informacionin dhe njoftimet rreth veprave penale tatimore që janë kryer ose mund të kryhen;
- b. mbledh dhe analizon informacionet nga brenda administratës tatimore qendrore dhe lokale, agjenci të tjera relevante dhe burimet jo-qeveritare mbi krimet tatimore;
- c. bashkëpunon me drejtorinë e teknologjisë dhe informacionit në drejtorinë e përgjithshme të tatimeve, për të krijuar dhe administruar një bazë kombëtare qendrore të dhënash për inteligjencën tatimore;
- d. kryen shkëmbim të efektshëm informacioni me drejtorinë rajonale me zyrat e taksave të pushtetit vendor dhe me agjencitë e tjera;
- e. ndihmon departamentet dhe sektorët e tjerë të administratës tatimore qendrore dhe lokale për të zbuluar skemat e shmangies dhe evazionit tatimor;
- f. regjistron informacionin e marrë, veprimet e ndërmarra dhe përpilon raporte të përmuajshme të veprimeve për drejtorinë e drejtorise së inteligjencës;
- g. merr masa që të gjitha metodat për mbledhjen dhe shpërndarjen e informatave të jenë në përputhje me dispozitat penale;
- h. përgatit dhe mirëmban manuale operacionale lidhur me funksionet e sektorit të inteligjencës si dhe
- i. harton qarkore mbi çështje specifike;
- j. krijon kanale të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit, periodik ose me kërkesë me prokurorinë, policinë e shtetit, policinë doganore, policinë e ndertimit dhe me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Neni 30

Funksionet e drejtorise së investigimit

Drejtoria e investigimit të krimeve tatimore ka funksionet e mëposhtme:

- a. zbaton procedurat ligjore për parandalimin, hetimin dhe denimin e veprave penale tatimore, në përputhje me dispozitat e kodit të procedurave penale për zbulimin e veprave penale tatimor;
- b. bashkëpunon me prokurorinë, policinë e shtetit, policinë doganore, policinë e ndertimit dhe me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit, në fushën e parandalimit, zbulimit dhe luftimit të veprave penale tatimore, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe marrëveshjet ndërkombëtare;
- c. analizon rezultatet e çështjeve për të cilat ka vendim gjykatë dhe bën rekomandime për ndryshime në ligj apo procedura, në shërbim të zbatimit të efektshëm të legjislacionit tatimor;
- d. analizon rezultatet e rasteve të hetuara dhe të proceduara dhe bën rekomandime për përmirësime të legjislacionit lidhur me parandalimin, zbulimin dhe luftimin e veprave penale tatimore si dhe
- e. i përcjell prokurorisë rastet që përbejnë vepra penale.

Neni 31

Funksionet e drejtorise se verifikimit

Drejtoria e verifikimit ka per detyre:

- a. te zbatoje procedurat e mbledhjes me force te detyrimeve;
- b. te verifikoje dokumentacionin dhe lëvizjen e mallrave dhe perfaqesuesve tregtare ne te gjitha llojet e transportit;
- c. te verifikoje përdorimin e pullave te akcizes si dhe kërkesat e tjera qe lidhen me mallrat e akcizes, te zbatoje sanksionet per mungese perputhshmerie dhe te jape mbështetje per nepunesit tatimore gjate kryerjes se detyrave, siç përcaktohet ne ligjin e fushes;
- d. te asistojë nepunesit e tjere te administrates tatimore qendrore ne ekzekutimin e detyrave te tyre ne baze te nje kerkese me shkrim;
- e. të kryejë detyra të tjera, sipas percaktimit te bere ne rregulloren per pershkrimin e punes te miratuar nga drejtori i pergjithshme i tatimeve.

Neni 32

Funksionet e drejtorise rajonale

Drejtoria rajonale dhe njesite e tjera te ngjashme me te kane per detyre:

- a. te vene ne dispozicion te tatimpaguesve formularet e deklarimit dhe pageses se tatimeve dhe kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore me poste dhe ne menyre elektronike;
- b. te mbledhe tatimet dhe taksat kombetare si dhe kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore;
- c. te kryeje vleresimet tatimore per tatimet kombetare;
- d. te ushtroje kontrole tatimore;
- e. të pranojë pagesën e tatimit;
- f. të leshoje çertifikata ose vërtetime elektronike të regjistrimit për tatimpaguesin ose institucionete shteterore, kur kjo kerkohet me ligj të veçantë;
- g. të hartojë dhe t'i propozojë drejtorit te pergjithshem te tatimeve, planin e parashikimit te të ardhurave te deges tatimore;
- h. të kryejë detyra të tjera, sipas percaktimit te bere ne rregulloren per pershkrimin e punes te miratuar nga drejtori i pergjithshme i tatimeve.

Seksioni II

Detyra te tjera te administrates tatimore qendrore dhe lokale

Neni 33

Menyra e komunikimit me tatimpaguesin

Vlerësimet, njoftimet, vendimet dhe komunikimet zyrtare drejtuar tatimpaguesit i dergohen në adresën e shënuar në regjistrimin e tatimpaguesit duke përdorur shërbimin postar.

Si afati i marrjes dijeni per aktet dhe korrespondencen tjeter, që i dërgohet tatimpaguesit, do të konsiderohet të jetë shtatë ditë pas datës së dergimit. Date e dergimit do te konsiderohet data e pranimit te dokumentit nga ana e sherbimit postar.

Pergjegjësia per mosmarrjen ne kohe te njoftimit te dorezuar ne sherbimin postar, eshte e tatimpaguesit i cili eshte i detyruar te deklarroje adresen e sakte ne menyre qe te siguroje marrjen ne kohe te njoftimeve nga sherbimi postar

Neni 34

Dhenia e informacionit tatimor per te tretet

Informacioni tatimor ne lidhje me tatimpaguesin i administruar nga administrata tatimore, pas depozitimit te kerkeses, i ofrohet pa pagese autoriteteve te percaktuara ne kete nen, kur verifikohen rrethanat e meposhtme:

- a. gjyqtarit, nese eshte ne gjykim ose ne hetim te nje çështje civile te lidhur me nje tatimpagues per pjesen qe i takon marrdhenieve te tij me administraten tatimore;
- b. gjyqtarit ose prokurorit, nese eshte ne gjykim ose ne hetim te nje çështje penale te lidhur me nje tatimpagues per pjesen qe i takon marrdhenieve te tij me administraten tatimore;
- c. kontrollit të lartë të shtetit, vetem per rastet kur kerkesa e bere eshte ne funksion te kontrollit te kryer nga ky institucion ne funksion te hartimit te rekomandimeve te veta;
- d. autoritetit te ngjashem te huaj me te cilin Kuvendi ka ratifikuar marreveshje nderkombetare dhe informacioni kerkohet ne kuader te ekzekutimit te marrveshjes;
- e. autoritetit homolog te huaj ose autoriteteve vendase, me te cilat DPT ka nenshkrua marreveshje bashkepunimi dy ose shumepaleshe me objekt shkembimin e informacionit; si dhe
- f. çdo autoriteti tjeter sipas parashikimit te bere me ligj te veçante.

Neni 35

Konfidencialiteti

Punonjësit e administratës tatimore qendrore dhe lokale, ruajnë konfidencialitetin e te dhenave tatimore dhe financiare të tatimpaguesve, që ata e kanë siguruar gjatë kryerjes së detyrave të tyre.

Detyrimi per ruajtjen e konfidencialitetit vazhdon edhe pasi punonjësi nuk është më i punësuar pranë administratës tatimore.

Punonjësit e administratës tatimore, zbatojne në mënyrë të drejtë e të paanshme ligjet tatimore dhe nuk orientojne ose influencojnë tatimpaguesin ne veprimtarine e tij, si dhe te deklarojne paraprakisht rastet kur kanë lidhje të drejtpërdrejtë ose jo te drejtpërdrejte me tatimpaguesin.

Neni 36

Shkembimi i informacionit konfidencial

Shkembimi i informacionit, i bere ne ekzekutim te marrveshjeve te lidhura nga administrata tatimore, behet me kushtin e ruajtjes se konfidencialitetit per institucionet dhe individet qe marrin dijeni per te dhenat tatimore.

Kushti i ruajtjes se konfidencialitetit perfundon ne rastet kur tatimpaguesi heq dorë me shkrim nga e drejta e tij për ruajtjen e konfidencialitetit dhe per aq sa eshte lejuar ne deklarimin e bere nga tatimpaguesi.

Neni 37

Publikimi i informacionit tatimor

Administrata tatimore mund të publikojë informacionin e mbledhur nga veprimtaria e saj, me qëllim përdorimin e të dhenave tatimore në hartimin e statistikave. Publikimi behet në menyre dhe formë që nuk identifikon tatimpaguesit specifikë.

Neni 38 **Informimi i publikut**

Administrata tatimore ka për detyrë, që duke përdorur të gjitha mjetet e komunikimit, përfshirë median e shkruar dhe ato elektronike, t'i shpjegojë dhe informojë publikun në lidhje me përmbajtjen, rolin dhe rëndësinë e legjislacionit tatimor. Drejtorja e përgjithshme e tatimeve publikon materiale sqaruese, komantarë dhe materiale të tjera shpjeguese në lidhje me legjislacionin tatimor.

Informimi publikut, për ligjet e reja tatimore, ndryshimet e bëra për legjislacionin tatimor dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, kryhet nëpërmjet medias së shkruar dhe elektronike, si dhe faqes zyrtare së internetit të drejtorisë së përgjithshme të tatimeve, jo më vonë se 15 dite nga data e miratimit të tyre.

Neni 39 **Rregjistri i detyrimeve tatimore**

Administrata tatimore krijon dhe përditeson rregjistrin e detyrimeve tatimore, në të cilin regjistrohen të gjitha detyrimet e tatimpaguesit sipas kategorisë së tatimit, interesat, gjobave dhe pagesat që i takojnë tatimpaguesit.

Forma, menyra dhe afati i ruajtjes së të dhenave të këtij rregjistri përcaktohet me rregullore të miratuar nga drejtorit të përgjithshëm.

Neni 40 **Detyrat e zyrave të taksave të pushtetit vendor**

Përvëç parashikimeve të këtij ligji, administrata tatimore lokale ka të gjitha detyret dhe përgjegjësitë e parashikuara në ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore".

KREU IV **TE DREJTAT DHE DETYRIMET E TATIMPAGUESVE**

Seksioni I **Te drejtat e tatimpaguesve**

Neni 41 **E drejta për informim dhe asistencë**

Çdo tatimpagues ka të drejtë që pa shperblim me qëllim kuptimin dhe zbatimin e legjislacionit tatimor, të marrë informacion dhe të asistohet nga administrata tatimore. Brenda struktureve të administratës tatimore krijohen strukturat përgjegjëse për shërbimin e tatimpaguesve.

Çdo tatimpagues gëzon të drejtën e trajtimit të paanshëm, profesional dhe etik nga ana e administratës tatimore, lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me detyrimet tatimore.

Neni 42

E drejta për konfidencialitetin e të dhënave

Çdo tatimpagues gëzon të drejtën e konfidencialitetit për te dhenat e veta tatimore e financiare, të administruara nga administrata tatimore.

E dhene tatimore dhe financiare, eshte çdo informacion i cili, merret nga administrata tatimore gjate ushtrimit te funksioneve, tek tatimpaguesi ose palet e treta.

Neni 43 E drejta për njoftim

Çdo tatimpagues ka të drejtë të marre njoftim për çdo akt administrativ, veprim ose mosveprim i bere per qellim te mbledhjes se detyrimeve tatimore e qe prek pasurine e tatimpaguesit, me perjashtim te rasteve kur ka arsye te besojte se pas kesaj tatimpaguesi do te bente transferimin e pronësisë, para se të perfundonte vleresimi tatimor.

Neni 44 E drejta për kontrolle të arsyeshme

Tatimpaguesi ka të drejtën qe t'i sigurohen kontrolle te arsyeshme, të cilat te kryhen në kohë të arsyeshme, në vendin e duhur dhe brenda afateve, sipas dispozitave te këtij ligj.

Neni 45 E drejta për informim

Ne rastin e nje mosmarrveshje te lidhur me vleresimin tatimor te bere nga administrata tatimore, tatimpaguesi ka të drejtën te marre pergjigje me shkrim, ne lidhje me arsyet e vlerësimit si dhe të vendimit te marrë.

Në bazë të kërkesës me shkrim të tatimpaguesit, administrata tatimore lëshon vertetim ne lidhje me të ardhurat e tatueshme, të detyrimeve tatimore të mbetura si dhe pagesat e kryera nga tatimpaguesi.

Neni 46 E drejta për përfaqësim

Tatimpaguesi ka të drejtën të emërojnë një përfaqësues me prokure, i cili e perfaqeson ate ne raport me administraten tatimore.

Edhe ne rastin e emrimit te perfaqesuesit me prokure, tatimpaguesi mbetet personalisht përgjegjës në përmbushjen e detyrimeve të tij tatimore.

Neni 47 E drejta për te kërkuar evidenca me shkrim

Tatimpaguesi ka te drejte te kerkoje me shkrim nga administrata tatimore kopje te njesuara me origjinalin, per çdo dokument qe ndodhet ne dosjen e hapur per tatimpaguesin apo te kerkoje kopje te printuar dhe te çertifikuar te te dhenave elektronike te lidhura me tatimpaguesin.

Neni 47 E drejta për t'u dëgjuar

Perpara marrjes se nje vendimi administrativ te lidhur me tatimpaguesit dhe pasurine e tij, tatimpaguesi ka të drejtë të dëgjohet nga administrata tatimore.

Neni 49
E drejta për t'u ankimuar

Tatimpaguesi gëzon të drejtën që t'i sigurohet shqyrtimi pavarur administrativ i ceshtjeve të lidhura me të.

Seksioni II
Detyrimi për regjistrimin dhe mbajtjen e të dhënave
nga tatimpaguesi

Neni 50
Regjistrimi i individit tatimpagues

Si numer identifikimi për qëllime tatimore, për tatimpaguesin që është individ shërben numri personal i identifikimit i marrë në përputhje me legjislacionin e fushës.

Rregjistri i individëve mbahet nga administrata tatimore qendrore.

Neni 51
Regjistrimi i personave
që ushtrojnë veprimtari tregtare

E drejta për të ushtruar veprimtari tregtare e personit fizik dhe atij juridik, lind pas regjistrimit në përputhje me ligjin nr. 9723 datë 3.5.2007 "Për qendrën kombëtare të regjistrimit". Regjistrimi në qendrën kombëtare të regjistrimit është i vlefshëm edhe për efekt të regjistrimit në organet tatimore, në skemën e sigurimeve shoqërore, skemën e sigurimeve shëndetësore dhe në inspektoratin e punës.

Personi i regjistruar në qendrën kombëtare të regjistrimit, merr një numër unik identifikimi, të gjeneruar në formë elektronike, i cili shërben si numer identifikimi edhe për qëllime tatimore, në përputhje me procedurat e parashikuara në ligjin për qendrën e kombëtare të regjistrimit.

Mosrespektimi i detyrimit për regjistrim, nuk e çliron personin fizik ose juridik nga pagesa e detyrimeve tatimore.

Neni 52
Identifikimi i personave
që ushtrojnë veprimtari tregtare pa u regjistruar

Kur administrata tatimore, identifikon persona të cilët ushtrojnë veprimtari tregtare pa u regjistruar në qendrën kombëtare të regjistrimit, i regjistron ata në një regjistër të përkohshëm.

Keta persona detyrohen që brenda 15 ditëve nga identifikimi i tyre nga administrata tatimore, të regjistrohen në qendër kombëtare të regjistrimit. Nëse personi nuk regjistrohet brenda afatit të parashikuar nga ky paragraf, atij i mbyllet veprimtaria dhe nuk mund të regjistrojë veprimtari tjetër për një periudhë prej gjashtë muajsh.

Deri sa të përfundojë regjistrimi i tyre në qendrën kombëtare të regjistrimit, administrata tatimore, përlogarit dhe mbledh detyrimin tatimor si dhe gjatë administrativë në përputhje me këtë ligj.

Neni 53

Regjistrimi i organizatave jo-fitimprurese

Organizatat jo-fitimprurëse, rregjistrohen ne organet tatimore, mbasi kane kryer me pare regjistrimin ne perputhje me Kodin Civil. Administrata tatimore mban një regjistër elektronik të veçantë për këta persona.

Ne regjistrin e organizatave jo-fitimprurese rregjistrohen keto te dhena:

- a. emri;
- b. kohezgjatja, nese kjo eshte e përcaktuar;
- c. objekti i veprimtarisë;
- d. vendi i ushtrimit të veprimtarise;
- e. të dhënat personale të anëtarëve;
- f. vlera dhe lloji i kontributeve të anëtarëve;
- g. te dhënat personale te drejtuesve dhe përfaqësuesve ligjore te organizates ne raport me te tretet, te drejtat e dhena me aktin e përfaqësimit si dhe afatet e emërimit;
- h. specimenet e firmave te perfaqesuesve te organizates ne raport me te tretet;
- i. numrin e te punesuarve.

Rregjistrimi ne administraten tatimore te organizatave jo-fitimprurese behet pas depozitimit ne administraten tatimore te formularit te kerkeses se bashku me dokumentacionin bashkelidhur te parashikuar ne formular. Formulari i kerkeses dhe dokumentacioni i kërkuar si pjesë e kerkeses publikuar ne faqen zyrtare te drejtorise se pergjithshem te tatimeve mund te merret pa pagese ne çdo sportel te njesive te shërbimit ndaj tatimpaguesit.

Administrata tatimore brenda 5 diteve nga marrja e formularit të plotë dhe të saktë të aplikimit, përpunon kerkesen për regjistrim tatimor dhe e pajis kerkuesin me numër identifikimi.

Mosrespektimi i detyrimit per regjistrim, nuk e çliron organizaten jo-fitimprurese nga pagesa e detyrimeve tatimore.

Neni 54

Përditësimi i te dhenave të rregjistrave

Tatimpaguesit qe jane persona fizik dhe juridik rregjistrojnë çdo ndryshim të dhënave siç përcaktohet në ligjin nr. 9723 date 3.5.2007 “Për qendrën kombëtare të regjistrimit”.

Tatimpaguesit te cilet direkt apo indirekt jane zoterues te mbi 50 % te kapitalit te nje shoqerie tregtare vendase apo te huaj, e deklarojne kete fakt prane autoritetit tatimor perkates.

Tatimpaguesi qe eshte shoqeri tregtare dhe behet zoterues ose kontrollues i nje shoqerie tregtare tjeter, e deklaron kete fakt prane autoritetit tatimor perkates.

Organizatat jo-fitimprurese depozitojne ne organet tatimore aktet perkatese per ndryshimet e meposhtme:

- a. ndryshimi i emrit;
- b. ndryshimi i vendit te ushtrimit te veprimtarise;
- c. ndryshimi i statusit ligjor;
- d. krijimin e degëve, sektorëve ose njësive të reja;
- e. ndryshim në objektin e veprimtarise;
- f. ndryshim ne numrin e punonjesve.

Neni 55

Kalimi ne regjistrin pasiv

Administrata tatimore kur ka prova se tatimpaguesi nuk ka kryer veprimtari ekonomike për të paktën dymbëdhjete muaj, mund ta transferojë regjistrimin e tatimpaguesit nga regjistri aktiv tek ai pasiv. Administrata tatimore njofton per kete transferin tatimpaguesin. Procedurat e kalimit ne regjistrin pasiv si dhe te rikthimit ne regjistrin aktiv percaktohen me udhezim te ministrit te financave.

Neni 56

Çrregjistrimi tatimor

Çrregjistrimi tatimor i tatimpaguesve qe jane persona fizik dhe juridik, behet sipas procedurave te parashikuara ne ligjin per qendren kometare te rregjistrimit.

Ne çdo rast, çrregjistrimi behet pasi tatimpaguesi të ketë paguar të gjithë detyrimet tatimore të papaguara. Për ato raste kur paraqitja e këtij bilanci kërkohet nga legjislacioni ne fuqi, çrregjistrimi behet pasi të depozitohet bilanci i mbylljes.

Qendra kombëtare e regjistrimit njofton organin tatimor kompetent për regjistrimin e hapjes se procedurave te likuidimit apo për kërkesën për çregjistrim të tatimpaguesit. Organi tatimor kompetent, brenda 45 ditësh nga data e këtij njoftimi verifikon gjendjen tatimore dhe, kur është e nevojshme, ushtron kontroll në vendin e veprimtarisë së tatimpaguesit.

Nëse organi tatimor kompetent, brenda 45 ditëve nga marrja e njoftimit sipas paragrafit 3 me sipër, paraqet kundërshtime për çregjistrimin e tatimpaguesit, qendra kombëtare e regjistrimit nuk kryen çregjistrimin. Kundërshtimi i hartuar nga organi tatimor kompetent për çregjistrimin e tatimpaguesit permban shumën e detyrimeve tatimore.

Nëse pas 45 ditësh nga data e njoftimit, organi tatimor kompetent nuk ka paraqitur ndonjë kundërshtim me shkrim, apo kundërshtimi nuk përmban shumën e detyrimeve tatimore, qendra kombëtare e regjistrimit kryen menjëherë çregjistrimin e tatimpaguesit.

Nese deri në datën e hapjes se procedurave te likuidimit apo te kërkesës për çregjistrim, tatimpaguesi ka shlyer detyrimet tatimore, organi tatimor kompetent tërheq pa vonese kundërshtimin për çregjistrim dhe qendra kombëtare e regjistrimit kryen menjëherë çregjistrimin e tatimpaguesit.

Nëse pavarësisht shlyerjes se detyrimit tatimor, organi tatimor kompetent nuk ka tërhequr kundërshtimin, atëherë tatimpaguesi i paraqet qendrës kombëtare te regjistrimit dokumentin qe vërteton shlyerjen e detyrimeve tatimore, te përshkuara ne kundërshtimin për çregjistrim. Pas depozitimit te dokumentit qe verteton shlyerjen e detyrimeve tatimore, qendra kombëtare e regjistrimit kryen pa vonese çregjistrimin e tatimpaguesit dhe njofton organin tatimor kompetent per kete veprim.

Në çdo rast, çregjistrimi nuk parashkruan detyrimin tatimor te mbetur dhe nuk e pengon administratën tatimore te beje vlerësime tatimore pas berjes se çregjistrimit.

Çrregjistrimi nga regjistri tatimor i organizatave jo-fitimprurese, behet ne baze te vendimit te gjykates.

Seksioni III

Detyrimi per dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive

për qellime tatimore

Neni 57
Dokumentimi dhe mbajtja e të dhënave tatimore
per tatimpaguesit qe jane subjekt i tvsh-se ose tatim-fitimit

Tatimpaguesit që janë subjekt i TVSH-së ose tatimit të fitimit, me qëllim perlllogaritjen e detyrimit tatimor, mbajnë regjistrat, dokumentacioni kontabel, librat dhe informacionin financiar si dhe lëshojnë faturë tatimore, dëftesë tatimore ose kupon tatimor në përputhje me ligjet e fushes si dhe aktet nenligjore te nxjerra ne zbatim te tyre.

Tatimpaguesit subjekt i TVSH-së regjistrojnë menjëherë gjithë veprimet financiare dhe përgatisin dhe mbajnë libra dhe regjistra kontabël ne te cilet regjistrohen:

- a. shitjet e përditshme të mallrave ose kryerja e punimeve ose shërbimeve të tatueshme, duke përfshirë shumën e secilit veprim dhe shumën e tatimit të ngarkuar;
 - b. veprimet e përfunduara por akoma të pafaturuara;
 - c. veprimet e patueshme;
- si dhe
- d. pagesat për mallra dhe shërbime, përfshi shumën e secilës blerje ose pagesë, shumën e tatimit të paguar, dhe emrin dhe adresën e furnizuesit.

Neni 58
Dokumentimi dhe mbajtja e të dhënave tatimore
per tatimpaguesit e klasifikuar si biznes i vogel

Tatimpaguesit që janë subjekt i Ligjit “Për Taksën Vendore të Biznesit të Vogël”, me qëllim te perlllogaritjes se detyrimit tatimor, mbajnë regjistra, libra dhe dokumente të tjera si dhe lëshojnë fature te thjeshte tatimore apo kupona tatimorë, ne perputhje me dispozitat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 “Per sistemin e taksave vendore”.

Neni 59
Mbajtja dhe ruajtja e dokumentave te te dhenave tatimore

Regjistrat, librat dhe informacioni financiar jane dokumenta te cilat permbajne informacionin e regjistruar ne menyre kronologjike dhe sistematike te veprimeve tregtare të tatimpaguesit, dhe te cilat mbahen me qëllim të përcaktimit te shumes e detyrimeve tatimore të këtij tatimpaguesi.

Të dhënat dhe informacioni financiar dhe kontabël ruhen nga tatimpaguesi për te pakten gjashte vjet duke filluar nga fundi i vitit tatimor të cilit i përkasin dokumentet.

Tatimpaguesi per çdo shitje leshon fature tatimore ose kupon tatimor.

Neni 60
Fatura tatimore

Çdo shit-blerje mallrash apo te drejtash si dhe çdo kryerje punimi apo shërbimi që eshte pjese e veprimtarise tregtare është objekt faturimi.

Faturat për shitjen e sendeve a kryerjen e punimeve e të shërbimeve janë fatura tatimore, të cilat perfishihen ne perlllogaritjet e detyrimit tatimor.

Fatura tatimore përmban numrin rendor dhe numrin personal te identifikimit, numrin e identifikimit te tatimpaguesit, datën dhe vendin e lëshimit, emrin dhe adresën e palëve, datën e realizimit të shitjes ose të punimit a shërbimit, emërtimin e saktë të

tyre, çmimin e plotë të shitjes dhe nëse është rasti, rritjet ose zbritjet e tjera të zbatuara, si dhe shumat e shifruara, cilado qoftë mënyra e likuidimit të faturës.

Neni 61 **Fatura tatimore me tvsh**

Tatimpaguesi që i nënshtrohet tatimit mbi vlerën e shtuar, sa here që ofron mallra apo shërbime për një person tjetër, duhet të leshtë fature tatimore me tvsh.

Ministri i financave me udhëzim mund të parashikojë transaksione për të cilat nuk ekziston detyrimi i leshtimit të një fature tatimore duke përcaktuar kriteret për dokumentimin e këtyre transaksioneve.

Përveç përshkrimeve dhe të dhënave të parashikuara në paragrafin e tretë të nenit me sipër, fatura tatimore me tvsh përmban :

- a. vlerën mbi të cilin përllongaritet tvsh-ja;
- b. vlerën me tvsh të zbatuar sipas kategorive të sendeve, punimeve e shërbimeve
- c. shumën e tvsh-se.

Ministri i Financave me udhëzim, mund të përcaktojë kërkesa të tjera që duhet të përmbajë një faturë tatimore për rastet që rrjedhin nga veçoritë e veprimtarive të zhvilluara, të sendeve të tregtueshme, të punimeve apo të shërbimeve.

Neni 62 **Lëshimi i faturës tatimore**

Shitësi lëshon faturë tatimore dhe blerësi duhet të kërkojë atë në kohën e realizimit të shitjes a të kryerjes së punimit ose shërbimit. Mallrat në qarkullim të pashoqerua me fature tatimore, konfiskohen nga policia tatimore.

Fatura tatimore përgatitet nga shitësi në jo më pak se dy ekzemplarë, nga të cilët njëren kopje e merr dhe ruan blerësi, kurse kopjen e mban dhe e ruan shitësi. Faturat përgatiten me numër rendor progresiv.

Neni 63 **Prodhimi dhe shpërndarja e dokumentave tatimore**

Ministri i financave miraton formatin e fatures tatimore.

Kriteret që duhet të plotësojnë personat që liqencohen për shtypjen dhe shpërndarjen e dokumentacionit tatimore, kushtet e shtypjes, standartet e sigurisë si dhe rregullat e shpërndarjes dhe venies në dispozicion të tatimpaguesve të faturave tatimore, miratohen me vendim të keshillit të ministrave.

Liçencat për shtypjen dhe shpërndarjen e dokumentave tatimore, leshohen nga Drejtori i përgjithshëm i tatimeve.

Neni 64 **Faturat tatimore të përgatitura nga blerësi**

Në rastin e shitjeve nga individët që nuk kanë cilësinë e tregtarit, fatura përgatitet nga blerësi, ushtrues i veprimtarisë tregtare, me kusht që dokumenti të përmbajë përshkrimet dhe të dhënat e parashikuara në këtë ligj dhe vërtetohet nga furnizuesi. Blerësi për çdo rast të tillë shënon në faturë edhe numrin e tij të identifikimit.

Ministri i Financave me udhëzim mund të parashikojë forma të posaçme dokumentesh që zënë vendin e faturës.

Neni 65

Kuponi tatimor

Kuponi tatimor është dokumenti i lëshuar me anë të arkave regjistruese a të pajisjeve elektronike të tjera që kanë aparat shtypshkrimi.

Subjektet që detyrohen të lëshojnë kupona tatimorë, mund të lëshojnë njëherazi edhe faturë, nëse shitja apo shërbimi i kryer është për një përdorim tregtar dhe për këtë shkak blerësi është i detyruar ta kërkojë faturën.

Te gjithë tatimpaguesit e shitjeve me pakice që shesin mallra apo ofrojnë shërbime në ambjente apo njësi të përhershme të hapura për publikun, duhet të instatojnë arka regjistruese dhe të lëshojnë kupona tatimor për çdo transaksion.

Kuponi tatimor i pashoqëruar me faturë, nuk njihet si dokument justifikues i shpenzimeve për blerësin, ushtrues të një veprimtarie tregtare.

Seksioni IV

Pajisjet fiskale

Neni 66

Detyrimi për përdorimin e pajisjeve fiskale

Dispozitat e këtij kreu synojë shtrirjen e sistemit fiskal nëpërmjet pajisjeve fiskale për regjistrimin e pagesave me para në dorë.

Tatimpaguesit që kryejnë qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve për të cilat pagesat nuk kryhen nëpërmjet bankës, janë të detyruara të fusin dhe të përdorin sistemin fiskal nëpërmjet përdorimit të pajisjeve fiskale për regjistrimin e pagesave me para në dorë dhe lëshimit në mënyrë të detyrueshme të kuponit tatimor.

Neni 67

Sistemi fiskal i pajisjeve

Sistemi fiskal i pajisjeve përfshin pajisjen fiskale si dhe sistemin e integruar automatik të kontrollit.

Pajisjet fiskale përfshijnë:

- 1- arkat regjistruese elektronike me memorje fiskale;
- 2- printera fiskalë;
- 3- sistem elektronik me memorje fiskale për regjistrimin e qarkullimit të shitjes me pakicë të derivateve të naftës nëpërmjet pajisjeve kalkuluese dhe konsumin e karburanteve të lëngshme (stacionet e naftës, të gazit etj) dhe
- 4- lexues të pagesës me kartë;
- 5- sistemi automatik i integruar i kontrollit është një sistem për komunikimin e vazhdueshëm elektronik të entitetit tregtar me administratën tatimore, për transferimet e përditshme automatike si një deklarament financiar ditor.

Neni 68

Lëshimi i kuponit tatimor

Tatimpaguesi është i detyruar të lëshojë kuponin tatimor në formë, dhe përmbajtjen e miratuar me udhëzim nga Ministri i Financave.

Bileta që nuk përmban elementët e përcaktuara, nuk do të konsiderohet kupon tatimor.

Me qëllim të rregjistrimit të rregullt të qarkullimit, tatimpaguesi është i detyruar të ruajë dhe mirëmbajë në kushte pune paisjen fiskale.

Neni 69

Ruajtja e kuponit tatimor

Blerësi i mallrave, apo përfituesi i shërbimit është i detyruar të kërkojë kupon tatimor dhe ta ruajë atë jo më pak se 30 metra larg nga pika e shitjes së mallrave, apo shërbimit dhe ta tregojë atë në rastin e kontrollit.

Kur pika e shitjes së mallrave, apo e ofrimit të shërbimit është vendosur në ndërtesa të cilat shfrytëzohen edhe nga tatimpagues të tjerë, tregje të organizuara apo qendra tregtare, largimi nga pika e shitjes do të konsiderohet distance nga dalja jashtë ndërtesave, tregut apo qendres tregtare.

Në rastet e kthimit të mallrave, për transaksionin e anuluar leshohet një dokument fature arke.

Neni 70

Detyrimi për të kërkuar kupon tatimor

Tatimpaguesi është i detyruar të afishojë një poster në një vend të dukshëm, me të cilin blerësi i mallrave apo përfituesi i shërbimit kujtohet për detyrimin e tij për të kërkuar kuponin tatimor.

Neni 71

Pjesët e kuponit tatimor

Kuponi tatimor përmban kuponin dhe gjurmën e kontrollit të kuponit që janë identike dhe që printohet në të njëjtën kohë. Strisha e gjurmës së kuponit i jepet blerësit të mallrave apo përfituesit të shërbimit dhe gjurma e kontrollit të kuponit mbahet nga tatimpaguesi.

Neni 72

Perjashtimi nga detyrimi i leshimit të kuponit tatimor

Detyrimi për leshimin e kuponit tatimor nuk shtrihet mbi:

- 1- tatimpaguesit që paguajnë tatimit mbi të ardhurat nga kryerja e veprimtarive për shumën të vogël të të ardhurave neto, me përjashtim të shoferëve të taksisë;
- 2- qarkullimin e produkteve bujqësore dhe të papërpunuara nga personat që nuk janë tregëtarë dhe realizojnë qarkullim mbi tezgat në tregjet e organizuara si dhe jashtë merkatave;
- 3- individët që leshojnë me qira, ambiente biznesi
- 4- veprimtari, të cilat ushtrohen në zona të larta malore me popullim më pak se 300 individë dhe që janë të ndryshme nga vendet turistike.

Neni 73

Instalimi i pajisjes fiskale

Tatimpaguesi është i detyruar të instalojë e përdorë paisjen fiskale për çdo vend pune ku është realizohet pagesa në të holla në dorë të mallrave apo shërbimeve.

Në ambjentet ku janë vendosur në përdorim më shumë se një paisje fiskale, të dhënat për futjen e cdo paisje në veprim, regjistrohen në librin e deklarimit ditor financiar.

Me përjashtim të rasteve kur është e nevojshme mirëmbajtja apo riparimet e paisjes fiskale dhe tatimpaguesi nuk është i detyruar të zotërojë paisje fiskale rezervë, është i ndaluar qarkullimi i mallrave apo shërbimeve që nuk janë kryer nëpërmjet instalimit dhe sistemit të paisjes fiskale.

Ne rast defekti të pajisjes fiskale, tatimpaguesi njofton menjehere subjektin e autorizuar për mirëmbajtjen si dhe administratën tatimore dhe mban proces-verbal të cilin e nënshkruan vetë.

Në rastin e parashikuar në paragrafin e tretë të këtij neni, tatimpaguesi është i detyruar të leshojë një faturë tatimore për cdo transaksion të lidhur me mallrave apo shërbimeve dhe të mbajë libër llogarie të çertifikuar nga administrata tatimore.

Neni 74

Pajisja fiskale zëvendësuese

Keshilli i ministrave miraton kategoritë e tatimpaguesve, kushtet dhe procedurat për sigurimin dhe regjistrimin e paisjes fiskale të përdorshme në rastet e dëmtimit apo gjatë shërbimeve të mirëmbajtjes së paisjes kryesore fiskale..

Neni 75

Kriteret për pajisje me liçence për ofrimin e pajisjeve fiskale

Subjektet e liçencuara për shitjen apo dhenien me qira të pajisjeve fiskale duhet të plotësojnë të paktën këto kushte:

- 1- të depozitojnë një garanci bankare në një vlerë prej 500 000 \$;
- 2- të sigurojnë pjesë këmbimi, shërbimi dhe asistencë teknike;
- 3- të ketë të paktën tre qendra shërbimi në Republikën e Shqipërisë;
- 4- të sigurojnë të paktën një shërbim mirëmbajtje gjatë vitit si mirëmbajtje parandaluese;
- 5- të sigurojnë riparim apo zëvendësim të pajisjeve fiskale brenda 36 orëve, nga momenti kur përdoruesi i paisjes ka kërkuar ndërhyrjen;
- 6- të kenë të punësuar të paktën një teknik mbi jo më shumë se 300 paisje fiskale, në zonën e shërbimit.

Liçencimi i subjekteve që ofrojnë shërbime të shitjes apo dhenies me qira të pajisjeve fiskale, behet nga Ministri i Financave, në përputhje me rregullat e miratuara nga keshilli i ministrave.

Në rast të mosrespektimit të të paktën një prej kushteve të parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni, autorizimi pezullohet për një periudhë pesë muajore.

Neni 76

Kontrolli i sistemit automatik të integruar

Kontrolli automatik i integruar kryhet nëpërmjet një sistemi të kontrollit.

Shërbimi i sistemit të kontrollit automatik të integruar kryhet nga subjektet e pajisura me liçence nga drejtori i përgjithshëm i tatimeve, dhe për zgjidhet mbi bazën e kriterëve të parashikuar me vendim të keshillit të ministrave.

Neni 77

Aktet nenligjore për pajisjet fiskale

Ministri i Financave me udhezim miraton karakteristikat teknike funksionale të paisjeve fiskale dhe të sistemit të kontrollit automatik të integruar, procedurën dhe dokumentacionin për miratimin e tyre për përdorim, elementët e kuponit tatimor, mënyrën e kontrollit dhe kontrollin e paisjes fiskale dhe rregullat për mirëmbajtjen e tyre teknike dhe të shërbimit.

Seksioni V **Mbajtja e kontabilitetit per qellime tatimore**

Neni 78 **Librat kontabël tatimore**

Kontabiliteti mbahet ne perputhje me ligjin nr. 9228 date 29.04.2004 “Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”

Çdo tatimpagues, regjistron në mënyrë të plotë, të rregullt dhe në kohën e duhur të gjitha veprimet e kryera, me qëllim që të justifikojë shumën e detyrimit tatimor, derdhjen e pagimin e tij si dhe të japë te dhenat e nevojshme për kontrollin nga administrata tatimore ose nga organe të tjera të autorizuara me ligj.

Për regjistrimin e veprimeve ekonomike që lidhen me tatimet dhe taksat përdoren librat dhe regjistrat e kontabilitetit që subjekti mban në zbatim të detyrimeve kontabël. Nëse librat e kontabilitetit të mbajtur normalisht rezultojnë të pamjaftueshëm ose nuk përmbushin kërkesat ligjore për tatimet dhe taksat, atëherë përdoren libra të posaçëm.

Llojet dhe format e librave të posaçëm, përcaktohen me udhëzim të veçante të miratuara nga Ministri i Financave.

Neni 79 **Regjistrimi i veprimeve** **objekt i perlllogaritjes se detyrimit tatimor**

Çdo tatimpagues për tatimet e këkuara mbi shitjen e mallrave ose mbi kryerjen e punimeve te shërbimit, regjistron shumen e çdo veprimi të kryer.

Përveç veprimeve të tatueshme në librin kontabël ose në librin e posaçëm, vihen në dukje në mënyrë lehtësisht të dallueshme edhe :

- a. veprimet e patatueshme ;
- b. veprimet e kryera, por të mbetura pezull për tatimin e dhënë;
- c. për çdo veprim shitjeje, kryerje punimi a shërbimi, treguesin e shumës së tyre, të tatimit përkatës, si dhe emrin dhe adresën e furnitorit ;
- d. për çdo veprim shitjeje, kryerje punimi a shërbimi, shumën sipas çmimit të shitjes, shumën e tatimit sipas tarifës së zbatuar, si dhe emrin e adresën e klientit.

Seksioni VI **Detyrime te tjera te tatimpaguesit dhe te treteve**

Neni 80 **Detyrimi i tatimpaguesit për të dhënë informacion**

Tatimpaguesi vë në dispozicion të administratës tatimore informacionin, dokumentet e nevojshme për të kryer llogaritjen e saktë të detyrimeve të tyre tatimore,

vë në dispozicion librat e llogarisë si dhe me kërkesën e administratës tatimore, jep sqarime shtese, me gojë ose me shkrim. Ky detyrim përfshin, por nuk kufizohet në:

- a. plotësimin, nënshkrimin dhe kthimin e pyetësorëve ose kërkesave të tjera me shkrim për informacione ose dokumente nga administrata tatimore brenda 20 ditëve nga data e postimit të kërkesës ose dërgimit elektronik tek tatimaguesit;
- b. takimin me punonjës të administratës tatimore gjatë orarit të punës për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe dhënë informacion.

Kërkesa e administratës tatimore për sqarime shtese, behet vetem për informacione të lidhura me transaksionet tregtare të tatimpaguesit, proceset ose procedurat teknike, dhe operacione financiare ndërmjet tatimpaguesit dhe palëve të treta.

Neni 81

Detyrimi i të tremeve për të dhënë informacion

Me qëllim përlogaritjen dhe mbledhjen e detyrimeve dhe borxheve tatimore, të tretet i krijojnë akses administratës tatimore në lidhje me të dhenat që ata zoterojnë në lidhje me tatimpaguesin, i cili është objekt i kontrollit tatimor ose ndaj të cilit ka filluar hetim për shkelje të legjislacionit tatimor.

Me kërkesën me shkrim të administratës tatimore, brenda 20 ditëve nga data e postimit ose dërgimit elektronik të kërkesës, palët e treta vëne në dispozicion të administratës tatimore pa pagese, informacionin dhe dokumentacionin e nevojshme për përlogaritjen e detyrimit tatimor të tatimpaguesve.

Kërkesa me shkrim behet për të dhenat e nevojshme për të përlogaritur detyrimin tatimor dhe ju drejtohet:

- a. personave juridikë, në lidhje me:
 - (1) dividendët që u paguhen aksionerëve ose ortakëve;
 - (2) personat me të cilët janë duke kryer ose kanë kryer transaksione financiare ose tregtare;
 - (3) pagesat e bëra për nën-kontraktorët apo në pozicionin e nën-kontraktorit ose
 - (4) debitorët dhe kreditorët
- b. bankave dhe institucioneve financiare, në lidhje me:
 - 1- pagesat e interesit;
 - 2- depozitat dhe detyrimet në fund të vitit ose
 - 3- veprime të tjera bankare;
- c. shoqëritve komisionere ose fondeve të investimeve kolektive, në lidhje me transaksionet e titujve;
- d. agjentëve të pasurisë së paluajtshme, në lidhje me veprimet për klientë e tyre;
- e. blerësve ose shitësve të pasurisë së paluajtshme, në lidhje me përshkrimin dhe çmimin e pasurisë së paluajtshme;
- f. notereve, për veprime noteriale lidhur me shitblerje të pasurive të luajtshme apo të paluajtshme, apo kontrata sipermarrje;
- g. personave juridikë rezidentë dhe jo-rezidentë në lidhje me pagesat e bëra personave jo-rezidentë;
- h. institucioneve shtetërore si dhe nepunesve të administratës shtetërore;
- i. kontraktoreve të tjera të tatimpaguesit
- j. donatorëve, organizatave ndërkombëtare, organizatave jofitimpruese vendase dhe të huaja, në lidhje me pagesat e bëra tatimpaguesve për furnizimin e mallrave dhe të shërbimeve.

Neni 82

Detyrime te pergjithshme te tatimpaguesit

Pervec detyrimeve te tjera te parashikuara ne kete ligj, tatimpaguesi ne perputhje me legjislacionin tatimor duhet:

- a. te regjistrohen ne regjistrin perkates;
- b. te dorëzojne ne menyre te plotë dhe të saktë deklaratave tatimore;
- c. te dorezojne deklaratat tatimore brenda afatit te percaktuar në secilin prej ligjeve tatimore;
- d. te kryerjen e pagesës së plotë të detyrimeve tatimore brenda afateve dhe datave te percaktuara në secilin prej ligjeve tatimore;
- e. te mbaje librat dhe regjistrimet e të dhënave tatimore;
- f. per cdo transakcion qe e kalon vleren 30.000 lek, nuk mund te beje arketime apo pagesa me lek ne dore, por keto transakcione duhet te kryhen nepermjet bankes;
- g. brenda 20 diteve te jape informacionin dhe dokumentacionin të kërkuar nga administrata tatimore gjatë procesit të vleresimit tatimor si dhe gjatë procesit të mbledhjes me force te detyrimeve tatimore per tatimpaguesin apo per te tretet;
- h. te ruajne, perdorin dhe transportojne mallrat te shoqeruar me dokumentin tatimor perkates;
- i. te reklamojne ne vende te dukshme, çmimet e mallrave dhe te sherbimeve qe ofrojne
- j. ne rastet kur ushtron njekohesisht tregti me shumi dhe me pakice, eshte i detyruar qe t'i organizoje keto veprimtari ne vende te veçanta te ndara nga njeri tjetri.

KREU V

DEKLARIMET DHE VLERESIMET

Neni 83

Deklarata tatimore

Deklarata tatimore eshte dokument i njohur nga administrata tatimore, me ane te te cilit tatimpaguesi ben vetevleresimin dhe vetdeklarimin e shumes se tatimit, takses apo kontributit.

Tatimpaguesi ploteson dhe dorëzon deklaraten tatimore, si dhe paguan tatimin, taksen apo kontributin e vleresuar brenda afateve të percaktuara në ligjet përkatës tatimore.

Kur ligji tatimor kërkon dorëzimin e deklarates tatimore, tatimpaguesi bën vetdeklarim të shumes se tatimit, takses apo kontributit, pa pritur vlerësimin, njoftimin ose kërkesën nga administrata tatimore.

Deklaratat dhe formularët e tjerë që duhen dorëzuar nga tatimpaguesi, vihen ne dispozicion te publikut pa pagese nepermjet:

- 1- publikimit në faqen zyrtare e internetit të administratës tatimore;
- 2- sporteleve e njesive te sherbimit per tatimpaguesin; ose
- 3- dërgimit me postë duke përdorur shërbimin postar me porosi per ata tatimpagues qe paraqesin kerkese me shkrim per ofrimin e ketij sherbimi.

Formatet e deklaratave si dhe dokumentacioni qe i bashkangjitet deklarates, miratohen nga drejtori i pergjithshem i tatimeve. Formulari permban detyrimisht

deklarimin e tatimpaguesit ose perfaqesuesit ligjor te tatimpaguesit, me te cilen konfirmon nën përgjegjësinë e vet që deklaratat janë të plota dhe të sakta.

Neni 84 **Dorëzimi i deklarates tatimore**

Tatimpaguesi dorëzon deklaraten tatimore nepermjet:

- 1- postës sipas dispozitave te ketij ligji;
- 2- në mënyrë elektronike ose
- 3- nepermjet bankes.

Keshilli i ministrave miraton rregullat e dorezimit te deklarates tatimore ne menyre elektronike.

Në rastet kur, afati i fundit per dorëzimin e deklarates bie ne dite pushimi, atehere si dite e fundit e aftatit llogaritet dita e pare e punës e cila vjen më pas.

Neni 85 **Zgjatja e afatit për dorëzimin e deklarates tatimore**

Në rastet kur tatimpaguesi ndodhet perpara pamundesise per dorezimin ne kohe te deklarates tatimore, ai paguan detyrimin tatimor dhe njofton administraten tatimore per periudhen e zgjatjes të afatit të dorëzimit të deklarates tatimore, e cila nuk mund te jete me e gjate se dy muaj.

Zgjatja e afatit për dorëzimin e deklarates tatimore, nuk ndikon në afatin e pagesës së detyrimit tatimor dhe ne perlllogaritjen e kamatë-vonesës për detyrimin tatimor i cili do te rezultojë si i papaguar ne momentin e dorezimit te deklarates tatimore.

Neni 86 **Vleresimi tatimor**

Vleresimi tatimor është perlllogaritja nga administrata tatimore, e detyrimit tatimor te tatimpaguesit.

Nese tatimpaguesit i kërkohet të dorëzojë deklaratë tatimore dhe të paguajë detyrimin tatimor, deklarata konsiderohet si vet-vlerësim tatimor. Pagesa e tatimit behet në menyren dhe afatin e parashikuar në ligjin tatimor përkatës. Shuma e detyrimit tatimor te deklaruar sipas deklarates tatimore, me vlere deri ne njemije lek, trajtohet si detyrim me vlere zero.

Nese tatimi i një tatimpaguesi mbahet në burim nga një agjent i mbajtjes së tatimit dhe tatimpaguesit nuk i kërkohet të dorëzojë deklaratë tatimore për tatimin e mbajtur në burim, mbajtja në burim e tatimit konsiderohet vlerësim tatimor.

Nese administrata tatimore konstaton se vetvleresimi tatimor i dhënë në deklaratën tatimore është i pasaktë, atehere nga administrata tatimore ribehet vleresimi tatimor.

Vlerësimi tatimor qe behet nga administrata tatimore bazohet në:

- a. informacionin e dhënë në deklaratën tatimore ose
- b. metodat alternative të vlerësimit.

Barra e provës per mosmarrveshjet e lindura ne lidhje me vleresimin tatimor te bere nga administrata tatimore, bie mbi:

- 1- administraten tatimore per te dhenat e perdorura per perlllogaritjen e detyrimit tatimor dhe
- 2- tatimpaguesin për pasaktësinë e shumës së detyrimit tatimor.

Neni 87

Njoftimi-vleresimi tatimor

Njoftim-vlerësimi tatimor permban shumën e tatimit të vlerësuar nga administrata tatimore.

Njoftim-vlerësimi tatimor i dergohet me poste tatimpaguesit dhe permban informacionin e mëposhtëm:

- a. gjeneralitetet e tatimpaguesit ose emrin e personit juridik;
- b. numrin e identifikimit të tatimpaguesit;
- c. datën e perfundimit të vlerësimit tatimor;
- d. arsyet e berjes së vlerësimit dhe periudhën tatimore të ciles i referohet vlerësimi tatimor;
- e. shumën e tatimit, taksës apo kontributit të vlerësuar, gjobat dhe menyren e perllogaritjes së interesave;
- f. kërkesën për pagesën e tatimit dhe afatin e pagesës;
- g. vendin dhe mënyrën e pagesës;
- h. shpjegimin për menyren e perllogaritjes së shumës së vlerësimit tatimor;
- i. të drejtën e tatimpaguesit që në rast se nuk është dakord me njoftim-vlerësimin mund të kërkojë kontroll tatimor.

Njoftim-vlerësimi rregjistrohet në regjistrin tatimor brenda 24 orëve.

Nëse tatimpaguesi nuk është dakord me vlerësimin tatimor të bërë nga administrata tatimore, ai brenda 24 orëve nga marrja e njoftim-vlerësimit, shprehet me shkrim për arsyet e kundërshtimit dhe kërkon kryerjen e kontrollit tatimor.

Neni 88

E drejta për të nxjerrë njoftim-vlerësimin tatimor

Njoftim-vlerësimi tatimor për tatimpaguesit e regjistruar pranë administratës tatimore qendrore nxirret nga drejtori i drejtorisë rajonale, kurse për tatimpaguesit e klasifikuar si biznes i vogël nxirret nga drejtuesi i zyrës së taksave të bashkisë ose komunes.

Për detyrimet tatimore të lidhura me kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore, njoftim-vlerësimi tatimor në të gjitha rastet nxirret nga drejtori i drejtorisë rajonale.

Vlerësimi i ri tatimor është vlerësimi i bërë nga administrata tatimore pas një ankimi apo në perfundim të një kontrolli tatimor dhe që ndryshon vlerësimin tatimor.

Neni 89

Rastet e zbatimit të metodave alternative të vlerësimit tatimor

Administrata tatimore mund të përdorë metoda alternative të vlerësimit tatimor në rastet kur:

- a. tatimpaguesi nuk dorëzon një deklaratë tatimore në kohën dhe menyren e kërkuar nga ligji tatimor përkatës;
- b. deklaratat tatimore permban të dhëna të pavërteta apo të paskta;
- c. tatimpaguesi nuk mban ose nuk ruan rregjistrime kontabel;
- d. tatimpaguesi kundërshton kryerjen e kontrolleve tatimore;
- e. të dhënat e deklaratës tatimore janë nën të dhënat referuese të investiguara nga tregu;

- f. tatimpaguesi nuk dorëzon informacionet e kerkuara dhe dokumente të tjera të nevojshme për perllogaritjen e detyrimit tatimor;
- g. tatimpaguesi kryen transaksione me persona të lidhur, ose përfshihet në transaksione tregtare të cilat në janë dukje pa përfitim thelbesor por kanë si qëllim pakesimin apo shmangien e detyrimit tatimor;
- h. tatimpaguesi përfshihet në shitje ose blerje me para në dorë në shuma më të mëdha se 30.000 lekë.

Neni 90

Bazat e metodave alternative të vlerësimit

Metodat alternative të vlerësimit bazohen në:

- a. prova direkte të dhëna në deklaratat tatimore ose në dokumente dhe informacione të tjera marra nga tatimpaguesi;
- b. prova direkte, dokumentacione dhe informacione të marra nga pale të treta përfshirë tatimpagues të tjerë;
- c. prova të tërthorta bazuar në të ardhurat ekonomike të veprimtarisë;
- d. krahasimin me një veprimtari tregtare të njëjtë ose të ngjashme të kryer nga tatimpagues të tjerë;
- e. çmimet e publikuara nga INSTAT apo të dhenat referuese për çmimet për çmimet e mallrave apo shërbimeve të nxjerra nga studimi i tregut ose
- f. të dhëna mbi shpenzimet e kryera nga tatimpaguesi dhe shpenzimet e kryera dhe mënyrën e jetesës së pronarëve dhe personave të lidhur me ta.

Tatimpaguesit që janë subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar, për të gjitha faturat tatimore pa TVSH, taten mbi bazën e çimeve referuese të shitjes me pakicë.

Kur behet vlerësim tatimor për transaksione ndërmjet personave të lidhur, metoda alternative e përdorur bazohet në të ardhurat e tatueshme që do të kishin rezultuar nga një veprim i krahasueshëm ndërmjet personave të palidhur.

Kur pretendohet se në mjedisin e shitjes me pakicë janë kryer edhe shitje me shumicë, këto të fundit vlerësohen sikur të jenë shitur me çmimet e shitjes me pakicë.

Metodat alternative direkte të vlerësimit kanë përparësi ndaj metodave të tërthorta. Në çdo rast administrata tatimore e bazon vlerësimin në gjykimin më të mirë të mundshëm referuar në faktet dhe rrethanat konkrete të veprimtarisë tregtare.

Drejtori i përgjithshëm i tatimeve miraton rregullore për procedurat administrative të vlerësimit tatimor nepermjet metodave alternative.

Neni 91

Afatet e parashkrimit të të drejtës për të bërë vlerësim tatimor

E drejta e administratës tatimore për të bërë një vlerësim tatimor, parashkruhet brenda gjashtë vjeteve nga dita e fundit e afatit të dorëzimit të deklaratës sipas ligjit tatimor përkatës.

Afati i parashkrimit i përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni, mund të zgjatet kur:

- a- si rezultat i një ankimi ndaj vlerësimit të mëparshëm, administrata tatimore bën një vlerësim tatimor të ri. Në këtë rast afati i parashkrimit është me i fundit nderjmet:
 - i. afatit kohor të përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni dhe

- ii. periudhes prej tridhjete ditesh nga miratimi i vendimit administrativ dhe kur ky vendim ankimohet ne rruge gjyqesore, nga data kur vendimi merr formë të prere;
- b- si rezultat i një kontrolli ose hetimi të tatimpaguesit nga administrata tatimore, nga kjo administrate kerkohet te behet vlerësim tatimor i ri. Në këtë rast afati i parashkrimit eshte me i fundit ndermjet:
 - i. afatit kohor te parashikuar ne paragrafin e pare te ketij neni dhe
 - ii. periudhes prej tridhjete ditesh nga nxjerrja e njoftimit-vleresimit tatimor te ri;
- c- ndaj tatimpaguesit ka filluar nje çeshtje penale lidhur me detyrimet e tij tatimore. Në këtë rast afati i parashkrimit eshte me i fundit ndermjet
 - i. afatit kohor te parashikuar ne paragrafin e pare te ketij neni dhe
 - ii. periudhes prej tridhjete ditesh nga data e marrjes nga gjykata te vendimit te formes se prere ne lidhje me çeshtje penale.

Ne rastet kur ndaj tatimpaguesit hapet nje çeshtje penale e lidhur me detyrimet e tij tatimore pas kalimit te afatit te parashikuara ne paragrafin e pare te ketij neni, e drejta per te bere vleresim tatimor konsiderohet se nuk eshte parashkruar.

KREU VI KONTROLI TATIMOR

Seksioni I

Prcedura dhe kompetenca ne miratimin e kontrollit tatimor

Neni 92

Kontrolli tatimor dhe kompetenca ne miratimin e fillimit te tij

Kontrolli tatimor eshte instrument i administrates tatimore per perllogaritjen e sakte te shumes se tatimit, taksës, kontributit apo detyrimit tatimor qe duhet paguar, per verifikimin e respektimit te legjislacionit tatimor, parandalimin dhe shmangjen e evazionit fiskal.

Evazion fiskal eshte cdo veprim i tatimpaguesit, i cili paraqet pamje te rreme te te dhenave tatimore, apo identifikuese me qellim shtremberimin e detyrimit tatimor per t'u paguar.

Fillimi i procedurave te kontrolleve tatimore, urdherohet nga drejtori i drejtorise rajonale apo njesive te ngjashme me to, per tatimpaguesite regjistruar prane administrates tatimore qendrore si dhe nga drejtuesi i zyres se tatim-taksave per tatimpaguesit e klasifikuar si biznes i vogel.

Kontrolli tatimor i urdheruar nga drejtues te administrates tatimore, mund te jete ne formen e:

- vizites fiskale;
- kontrollit periodik;
- kontrollit te plote.

Procedurat e kryerjes se kontrollit tatimor, miratohen me udhezim te ministrit te financave.

Neni 93

Qellimi i kontrolleve tatimore

Kontrollet tatimore kryhen ne funksion te verifikimit te respektimit te legjislacionit tatimor si dhe perllogaritjes se detyrimeve tatimore.

Grupi i kontrollit ka te drejta te plota te kontrollit ne lidhje me deklaratat, llogaritë dhe regjistrimet tatimore të tatimpaguesve, përfshirë gjithë dokumentacionin lidhur me të ardhurat, shpenzimet, aktivet dhe pasivet dhe marrëdhëniet financiare me palë të treta. Gjate kontrollit, administrata tatimore shqyrton saktësinë e dokumenteve që lidhen me statusin ligjor, statusin e rezidencës, veprimtarinë ekonomike, apo pagesën e detyrimeve tatimore, si dhe çdo dokumenti tjetër që është i nevojshem per përcaktimin e detyrimit tatimor.

Kontrolli tatimor mbeshtetet në deklaratat e dorëzuara nga tatimpaguesi, nga dokumente dhe informacione të siguruar nga palë të treta si dhe në metodat alternative të vlerësimit.

Kur tatimpaguesi pengon fillimin, apo vijimin e procedurave te kontrollit, grupi i kontrollit tatimor asistohet nga policia tatimore e cila sekuestron dokumentacionin tatimor. Ky dokumentacion i rikthehet tatimpaguesit pas perfundimit te vleresimit tatimor.

Urdheri per sekuestrimin e dokumentacionit tatimor, miratohet nga urdheruesi i kontrollit dhe ekzekutohet nga policia tatimore per tatimpaguesit e regjistruar prane administrates tatimore qendrore apo policia bashkiake per tatimpaguesit qe jane klasifikuar si biznes i vogel.

Neni 94 **Shtrirja e kontrollit tatimor**

Kontrolli tatimor kryhet ne lidhje me gjithe tatimpaguesit dhe te tretet te cilet zoterojne prova thelbësore per perlllogaritjen e detyrimit tatimor.

Kontrolli tatimor bazohet mbi parimin qe kontrollet gjithperfshirese dhe ne vazhdimesi, kryhen ndaj tatimpaguesve te medhenj. Per te gjithe tatimpaguesit e tjere, kontrollet kryhen ne menyre te tille qe te gjithe te perfshihen njesoj nga kjo lloj mbikqyrje.

Kontrolli tatimor bazohet në analizat e vlerësimit të riskut të kryer nga administrata tatimore.

Neni 95 **Njoftimi i kontrollit**

Njoftimi i kontrollit i dergohet tatimpaguesit menjehere në mënyrë elektronike si dhe me poste. Njoftimi dergohet me poste ne adresen e selise se tatimpaguesit ose ne vendin e ushtrimit te aktivitetit. Vendi i ushtrimit të aktivitetit nënkupton vendin ku kryhet administrimi efektiv i veprimtarise tregtare.

Njoftimi i kontrollit përmban informacionin e mëposhtëm:

- a. datën e fillimit te kontrollit, e cila nuk mund te parashikohet me pare sesa shtate dite nga data e dergimit me poste te njoftimit te kontrollit;
- b. llojin e kontrollit;
- c. gjeneralitetet e tatimpaguesit ose emrin e personit juridik;
- d. numrin e identifikimit të tatimpaguesit;
- e. qëllimin për të cilin bëhet njoftimi dhe periudha ose periudhat tatimore objekt kontrolli;
- f. arsyet e kontrollit
- g. grupin e inspektoreve tatimore qe marrin pjese ne kontroll si dhe
- h. kujtese ne lidhje me detyrimin ligjor për t'u dhënë informacion punonjësve tatimorë.

Neni 96

Afatet e kontrollit

Kontrollet zgjasin jo me shume se tre muaj. Afatet e kontrollit vendosen ne perputhje me klasifikimit e subjektit mbi bazen e volumit te veprimtarise dhe analizes se riskut.

Klasifikimi ne perputhje me volumen e biznesit dhe analizen e riskut, behet nga administrata tatimore ne perputhje me rregulloren e brendshme administrative dhe miratohet nga drejtori i pergjithshem i tatimeve.

Neni 97

Perjashtimi i inspektorit nga kontrolli tatimor

Organi vendimmarres qe ka miratuar njoftimin e kontrollit, perjashton ndonjerin prej individeve te emeruar me cilesine e inspektorit te kontrollit nese:

- 1- eshte i aferm i ndonjerit prej individeve te prekur direkt nga kontrolli tatimor;
- 2- eshte perfaqesues me prokure i tatimpaguesit te kontrolluar;
- 3- ka marrdhenie biznesi me tatimpaguesin e kontrolluar;
- 4- nese ka arsye te besohet qe mund te nxjerre perfitime direkte nga kontrolli apo te shkaktoje dem;
- 5- ka marre pjese ne vleresimin tatimor te bere tatimpaguesit te kontrolluar.

Per qellim te zbatimit te ketij ligji i aferm do te konsiderohet personi qe ka lidhje trashegimie deri ne shkalle te trete, kujdestari ligjor apo i biresuari.

Neni 98

Plani i kontrollit dhe kompetenca ne miratimin e njoftimit te kontrollit

Drejtori i pergjithshem i tatimeve mbi bazen e propozimeve te drejtoreve rajonale, miraton planin vjetor te kontrolleve tatimore.

Plani vjetor i kontrolleve tatimore miratohet brenda muajit janar te çdo viti tatimor.

Njoftimi i kontrollit hartohet nga urdheruesi i kontrollit.

Urdheruesi i kontrollit harton njoftimin e kontrollit:

- 1- me kerkesen e tatimpaguesit ne rastet kur tatimpaguesi nuk pranon detyrimin e nxjerre nga njoftim-vleresimi tatimor;
- 2- ne perputhje me planin vjetor te kontrollit;
- 3- mbi bazen e informacioneve te marra nga administrata tatimore e qe kane evidentuar nevojen e kryerjes se kontrolleve tatimore te tjera te paparashikuara ne plan ose
- 4- pas kerkeses me shkrim te drejtorit te pergjithshem te tatimeve.

Neni 99

Evidentimi i shkeljeve

Inspektoret tatimore, njoftojne tatimpaguesin dhe mbajne proces-verbal per shkeljet e konstatuara gjate kontrollit tatimor.

Neni 100

Projekt-raporti i kontrollit

Brenda 48 oreve nga perfundimi i kontrollit, grupi i inspektoreve te kontrollit përgatit projekt raportin e kontrollit i cili neshkruhet nga secili prej tyre. Projekt-raporti përshkruan me hollësi rezultatet e kontrollit dhe bazat për llogaritjen e vlerësimit të rishikuar te propozuar nese ka nje te tille.

Një kopje e projekt-raportit i dorezohet drejtoreve rajonale dhe nje kopje i dërgohet me postë tatimpaguesit.

Tatimpaguesi ka të drejtë të kundërshtojë me shkrim brenda 14 ditëve nga data e postimit te raportit. Ne kundërshtimin e hartuar nga tatimpaguesi vendosen pretendimet ligjore te tatimpaguesit si dhe menyren e perdorur prej tij per perlllogaritjen e detyrimit tatimor.

Neni 101 **Raporti perfundimtar i kontrollit**

Pas shqyrtimit te kundërshtimit, grupi i kontrollit harton raportin perfundimtar te kontrollit. Ne raportin perfundimtar te kontrollit arsyetohen pretendimet e tatimpaguesit te cilat jane konsideruar nga grupi i kontrollit si dhe arsyet e kundërshtimit te pretendimeve te paraqitura nga tatimpaguesi.

Raporti perfundimtar i kontrollit hartohet dhe neshkruhet nga grupi i inspektoreve te kontrollit dhe miratohet nga urdheruesi i kontrollit brenda tre diteve kalendarike nga data e marrjes se objeksioneve.

Anetaret e grupit te kontrollit nuk mund te refuzojne nenshkrimin e raportit perfundimtar te kontrollit. Ne rast se kane opinion te ndryshem per menyren e perlllogaritjes se detyrimit apo proceduren e ndjekur, i bashkangjisin raportit nje material te shkruar ne te cilin shpjegojne qendrimin e tyre personal ne lidhje me rastin.

Një kopje e raportit perfundimtar të kontrollit dhe vlerësimit të rishikuar i dërgohet tatimpaguesit.

Kur kontrolli rezulton me vlerësim tatimor te ri, ky vlerësimi hyn në fuqi 30 ditë pas postimit në seline e tatimpaguesit të një kopjeje të raportit të kontrollit.

Neni 102 **Permbajtja e raportit perfundimtar**

Raporti perfundimtar i kontrollit përshkruan vendin, daten dhe fillimin e kontrollit, përshkrimin e detyrave te kryera dhe fakteve dhe provave te siguruara ne procedure dhe te dhena te tjera mbi rrjedhen dhe rezultatin e kontrollit, vecanerisht fakteve te lidhura me ndryshimet ne detyrimin tatimor dhe nje prezantim te permbledhur te ndryshimeve te percaktuara ne detyrimet tatimore. Raporti mbahet ne menyre te rregullt dhe asgje nuk mund te shtohet ne te apo te hiqet nga ai. Seksionet e demtuara duhet te mbeten te lexueshme, dhe nese raporti ka me shume se nje faqe, cdo faqe duhet te kete numrin e saj dhe duhet te jete e firmosur.

Neni 103 **Rikontrolli tatimor**

Rikontrolli tatimor eshte rifillimi i procedurave te kontrollit mbi tatimpagues tek te cilet eshte kryer me pare kontroll tatimor. Rikontrolli bazohet mbi te njejtat parime dhe ndjek te njejtat procedura te parashikuara ne kete ligj ne lidhje me kontrollin tatimor.

Rikontrolli tatimor urdherohet nga drejtori i pergjithshem i tatimeve ne baze te kerkeses me shkrim te drejtorit te drejtorise rajonale, ne rastet kur :

- 1- administrata tatimore zoteron informacion te shkruar apo dokumenta te reja te cilat nuk zoteroheshin gjate kontrollit te meparshem tatimor, e te cilat mund te cojne ne nje perlllogaritje te re te detyrimit tatimor apo ne identifikimin e evazionit fiskal, si dhe
- 2- ne rastet kur ka arsye te besohet se gjate kontrollit te meparshem, grupi i kontrollit, ne perlllogaritjen e detyrimit tatimor, ka vepruar ne kundërshtim me ligjin.

Seksioni II **Perfshirja e eksperteve te tjere**

Neni 104 **Bashkepunimi me ekspertë te jashtem**

Me qellim vlerësimin e saktë te detyrimit tatimor, prane grupit te kontrollit mund te thirren eksperte te jashtem, te cilet ofrojne asistencë teknike në fusha specifike dhe per te cilat nuk gjenden eksperte brenda rradheve te punonjesve te administrates tatimore.

Ekspertit që asiston grupin e kontrollit, i vihet në dispozicion vetëm informacioni përkatës teknik. Eksperti respekton të njëjtat rregulla të konfidencialitetit si punonjësit e administratës tatimore.

Emërimi i ekspertëve të jashtëm bëhet nga drejtori i drejtorisë rajonale dhe pagesa e ekspertit bëhet në përputhje me legjislacionin per prokurimin publik.

Neni 105 **Asistenca e huaj**

Administrata tatimore mund te kerkoje asistencë nga nje autoritet tatimor i huaj per zgjidhjen e ceshtjeve tatimore specifike.

Asistenca e huaj kerkohet ne mbështetje te marrveshjeve dy ose shumepaleshe te lidhura me autoritete tatimore te huaja dhe nese nuk ka marrveshje te tilla, asistenca jepet e bazuar ne kushtet e meposhtme:

- a) ne parimet e reciprocitetit;
- b) nese administrata tatimore angazhohet per te perdorur informacionin, dokumentacionin dhe rezultatin e asistences per qellimet ekskluzive te ndjekjes se procedurave tatimore, dhe respektimit te legjislacionit tatimor;
- c) nese autoriteti tatimor i huaj qe jep asistencen shpreh gadishmerine dhe angazhohet te respektojte te njejtat rregulla ne lidhje me konfidencialitetit per te dhenat e marra per tatimpaguesit gjate periudhes se ofrimit te asistences.

KREU VII **MLEDHJA E DETYRIMEVE TATIMORE**

Seksioni I **Pagesa e detyrimit dhe** **kthimi i shumave te paguara me teper**

Neni 106 **Pergjegjesia dhe bazat e mbledhjes se detyrimeve tatimore**

Drejtoret e drejtorive rajonale apo njesive te ngjashme me to, si dhe kryetari i bashkise apo komunes jane autoritet pergjegjese per sigurimin e mbledhjes se detyrimeve tatimore.

Mbledhja e detyrimeve tatimore bazohet ne:

- 1- vet-deklarimin dhe vet-pagesen e detyrimit tatimor nga tatimpaguesi,
- 2- mbajtjen e tatimit ne burim nga agjenti i mbajtjes se tatimit si dhe
- 3- vleresimin tatimor.

Neni 107

Afatet e pageses se detyrimit tatimor

Tatimpaguesi shlyhen detyrimet tatimore brenda afateve te parashikuara nga legjislacioni tatimor per secilen takse, tatim, tarife apo kontribut te veçante.

Kur, administrata tatimore nxjerr vlerësimin e një detyrimi tatimor apo vlerësimin e ri tatimor, ky detyrim tatimor i vlerësuar rregjistrohet ne regjistrin e detyrimeve tatimore brenda 48 oreve dhe paguhet brenda 37 ditëve nga data kur vlerësimi futet në regjistrin e detyrimeve tatimor.

Kur afati i fundit për pagesen e detyrimit tatimor, bie ne dite pushimi, si data e pagesës do të konsiderohet dita e punës që vjen më pas.

Neni 108

Vendi dhe metoda e pageses së detyrimit tatimor

Detyrimi tatimor paguhet në mënyrë elektronike nëpërmjet bankave ose institucioneve te tjera që kanë lidhur marrëveshje me administratën tatimore për të pranuar dhe transferuar këto pagesa.

Ne faqen zyrtare te drejtorise se pergjithshme te tatimeve, publikohet lista e bankave dhe institucioneve te tjera qe kane lidhur marrveshje me administraten tatimore per ofrimin e sherbimit te shlyerjes se detyrimeve tatimore nga tatimpaguesit.

Ministri i Financave me udhezim miraton proceduren e kryerjes se pagesës elektronike të tatimeve. Pagesat e detyrimeve tatimore behen ne lek .

Neni 109

Detyrimet tatimore të paguara më tepër

Kur dalin dokumenta shtese qe vertetojne se vleresimi tatimor ka qene i pasakte, tatimpaguesi ka te drejte qe brenda tre vjeteve nga dita e kryerjes se pageses te kerkoje korrigjimin e aktit te vleresimit tatimor.

Drejtori i drejtorise rajonale shqyrton dokumentacionin shtese dhe brenda 30 diteve miraton apo refuzon kerkesen. Ne rastet ku kerkesa per korrigjimin e shumes se detyrimit miratohet, administrata tatimore:

a- e kalon shumën e paguar më tepër për llogari të detyrimeve të tjera tatimore të papaguara të tatimpaguesit; dhe pas kësaj

b- me miratimin me shkrim te tatimpaguesit, shuma e mbetur kalon për llogari të detyrimeve tatimore të mëvonshme të tatimpaguesit, ose

c- i kthehen tatimpaguesit brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës me shkrim nga tatimpaguesi.

Ne rastet kur perllogaritja gabim eshte bere per faj te administrates tatimore dhe tatimpaguesi kerkon kthimin e shumes, tatimpaguesit i paguhet edhe nje interes prej 0.04 % te te shumes se llogaritur dhe te paguar me teper, per çdo dite vonese.

Veprimet lidhur me shumën e paguar më tepër për detyrimet tatimore, regjistrohen në regjistrin e detyrimeve tatimore.

Neni 110 **Interesat**

Ne rastet kur detyrimi tatimor nuk paguhet në datën e caktuar, tatimpaguesi paguan interes për pagesë të vonuar në masën 0.04 % për çdo ditë vonesë.

Interesi është detyrimisht i pagueshëm. Ankimohen ato interesa për të cilat pretendohet se perlllogaritja është bere gabim

Neni 111 **Marrveshja pagesave me këste**

Kur një rrethanë financiare e tatimpaguesit e pengon atë të paguaje plotësisht detyrimet e tij tatimore në afatin e caktuar, ai mund të kerkoje të lidhe marrveshje pagese me këste.

Kërkesa behet me shkrim dhe i drejtohet drejtorit të drejtorise rajonale ose kryetarit të njesise së pushtetit vendor. Ne kerkese shpjegohen arsyet e pamundësisë për të paguar detyrimet e tij tatimore si dhe propozon marrveshjen e pageses me keste.

Marrveshja e propozuar, shqyrtohet brenda 5 ditesh Nëse marrveshja e propozuar miratohet, ajo nënshkruhet nga tatimpaguesi si dhe nga drejtori i drejtorise rajonale ose kryetari i njesise së pushtetit vendor. Drejtori i drejtorise rajonale i dergon menjehere drejtorit të pergjithshem të tatimeve, kopje të marrveshjes së nënshkruar.

Miratimi dhe nënshkrimi i marrveshjes së pageses me keste nuk e çliron tatimpaguesin nga detyrimi për të paguar interesin në lidhje me detyrimet tatimore për të cilat shtyhet pagesa sipas marrveshjes së pagesës me këste.

Marrveshja e pageses me keste parashikon vlerën e kesteve si dhe afatet e shlyerjes së secilit prej tyre.

Neni 112 **Zgjidhja e marrveshjes të pagesave me keste**

Marrveshja e pageses me këste parashikon zgjidhjen e menjehershme të saj në rastet kur:

- a. tatimpaguesi nuk paguan keestet;
- ose
- b. tatimpaguesi nuk paguan detyrimet e tjera tatimore që lindin gjatë periudhës së mbuluar nga marrveshja e pagesës me këste.

Vendimi për revokimin e marrveshjes së pageses merret nga drejtorise rajonale ose kryetari i njesise së pushtetit vendor, brenda 24 oreve nga mungesa e respektimit të njerit prej kushteve të parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni.

Nëqoftëse marrveshja e pagesës me këste revokohet, detyrimet tatimore të papaguara mbuluar nga marrveshja paguhet brenda 30 ditëve nga dita e nxjerrjes së vendimit për zgjidhjen e marrveshjes së pageses me keste.

Neni 113 **Radha e shlyerjes së detyrimeve tatimore**

Pagesat e kryera sipas marrveshjes së pageses me keste, shkojnë në favor të shlyerjes së pjesëve të detyrimit tatimor sipas rradhës së mëposhtme:

- a. interesat e vlerësuara;
- b. gjobat e vlerësuara;
- c. tatimit, takses apo kontributit të vlerësuar.

Per kontributet e sigurimeve shoqerore rradha e pageses eshte:

- a- kontributet epunemarresit;
- b- kontributet e punedhenesit.

Neni 114 **Borxhi tatimor**

Nëse tatimpaguesi,

- 1- ka nje detyrim tatimor te deklaruar ne deklaraten e vet tatimore, i cili nuk eshte paguar ne kohe, dhe ne lidhje me te cilin nuk jane bere objeksinet dhe nuk eshte kerkuar kontrolli tatimor brenda afateve ligjore si dhe nuk eshte miratuar ndonje plan pagese me keste;
- 2- ka nje detyrim te nxjerre nga kontrolli tatimor dhe ndaj te cilit nuk jane ushtruar te drejtat e ankimimit brenda afateve ligjore si dhe nuk eshte miratuar ndonje plan pagese me keste;
- 3- ka nje gjobe te vendosur nga administrata tatimore per shkak te veprimeve ne kundersizim me ligjin, te cilat nuk kane lidhje me pagesen e nje tatimi, takse apo kontributi e qe perbejne kundervajtje administrative si dhe per te cilen nuk eshte ushtruar e drejta e ankimimit;
- 4- nuk arrin të paguajë shumën e tatimit, takses apo kontributit të vlerësuar, brenda afatit të parashikuar për të drejtën e tij për apelim në komisionin e apelimëve të tatimeve, dhe për shlyerjen e detyrimit nuk është miratuar ndonje plan pagese me keste, ose
- 5- vendimi i gjykates i formes se prere njeh detyrimin tatimor dhe detyrime te tjera te tatimpaguesit ndaj administrates tatimore,

atehere brenda 48 oreve nga verifikimi i ndonjeres prej rrethanave te parashikuara ne kete paragraf, detyrimi tatimor si dhe detyrimet e tjera kontabilizohen si borxh tatimor.

Borxhi tatimor i pershkruar ne pika 3, te paragrafit te pare te ketij neni, kontabilizohet per llogari te administratorit te tatimpaguesit apo te individit qe ka pergjegjesi per perfaqesimin e tatimpaguesit ne raport me te tretet, pavaresisht nga emertimi qe mban ne strukturen e tatimpaguesit.

Administrata tatimore, detyrohet te beje ekzekutimin e vendimeve gjyqesore ne lidhje me detyrimin tatimor, te njohur nga gjykata me vendim te formes se prere. Ne te kundert, zyrat e permbarimit i ekzekutojn ato menjehere.

Seksioni II **Procedura e zakonshme** **e mbledhjes se detyrimit tatimor**

Neni 115 **Procedura e zakonshme**

Brenda 48 oreve nga kontabilizimi si borxh tatimor, drejtori i drejtorise rajonale apo i njesive te ngjashme me to, apo kryetari i zyrës së taksave të pushtetit vendor, i dërgon tatimpaguesit një letër kujtesë për pagimin e borxhit me paralajmërimin se në rast mos-pagimi do të fillojë zbatimin e masave shtërnguese.

Brenda 10 ditëve nga data e nisjes së letër kujtesës, drejtori i drejtorise rajonale apo i njesive te ngjashme me to, apo kryetari i zyrës së taksave të pushtetit vendor nxjerr një vendim të posaçëm ne te cilin i kërkon:

(a) çdo banke pranë të cilës tatimpaguesi ka një llogari bankare, qe t'i derdhë administratës tatimore nga llogaria e tatimpaguesit, shumën e borxhit tatimor për t'u paguar dhe ne rast se shuma e llogarisë bankare të tatimpaguesit eshte me e vogel se shuma e borxhit tatimor te papaguar, te kalohet e gjitha ne favor te administrates tatimore;

(b) çdo debitori të tatimpaguesit që të paguajë për autoritetin tatimor shumen e detyrimit për t'u paguar dhe ne rast se shuma e detyrimit per t'u paguar eshte me e vogel se shuma e borxhit tatimor te papaguar, te kalohet e gjitha ne favor te administrates tatimore. Ne kete rast tatimpaguesi njoftohet per zevendesimin e debitorit me administraten tatimore dhe per vleren e shlyer te borxhit tatimor.

Përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe, një vendim ekzekutiv i posaçëm i lëshuar në përputhje me këtë nen, ka përparësi mbi pagesën e detyrimeve tatimore dhe borxheve tatimore te lindura per periudhen ne vazhdim.

Vendim i posaçëm nuk mund të lëshohet për një detyrim tatimor që është subjekt i një apelimi.

Një kopje e çdo vendimi të posaçëm i dërgohet tatimpaguesit. Çdo orvatje e tatimpaguesit për të tërhequr, lëvizur apo fshehur fonde pas nxjerrjes së një vendimi të tillë, konsiderohet si përpjekje për të penguar ushtrimin e kompetencave te autoritetit tatimore.

Seksioni III

Procedura e jashtezakonshme e mbledhjes se detyrimit tatimor

Neni 116

Proçedura e jashtëzakonshme

Nëse edhe pas ndjekjes se procedurave te zakonshme kane mbetur ende borxhe apo pjese te borxheve tatimore te papaguar, atehere kalohet ne ndjekjen e procedurave te jashtezakonshme te cilat jane:

a) mbyllje e veprimtarisë ekonomike të tatimpaguesit deri sa ai të shlyejë detyrimet e papaguara e më tej, pas 30 ditëve,

b) sekuestrim,

c) pas 90 diteve nga momenti i leshimit te urdherit per sekuestrim, konfiskim të pasurisë së tatimpaguesit e më tej,

c) nëse masat e mësipërme nuk çojnë në shlyerjen e plotë të detyrimit të tij, drejtori i drejtorise rajonale, drejtori i pergjithshem i tatimeve ose drejtuesi i zyrës së taksave të pushtetit vendore, ben kallzim per ndjekje penal prane organeve te Prokurorisë dhe kërkon bllokimin e të gjitha transferimeve të sendeve ne zoterim së tatimpaguesit.

Miratimi i urdherave per zbatimin e procedurave te jashtezakonshme, ne lidhje me masat e parashikuara ne shkronjen a) dhe b) te paragrafit te pare te ketij neni, eshte kompetence e drejtorit te drejtorise rajonale per tatimpguesin e regjistruar prane administrates tatimore qendrore dhe drejtuesi i policise bashkiake per tatimpaguesin e regjistruar prane zyrave te taksave vendore.

Vendimi i posaçëm sipas shkronjes b) te paragrafit te pare të këtij neni, nuk kufizohet në shumën e borxhit tatimor të papaguar, por pasuria e sekuestruar nuk duhet ta tejkalojë atë të nevojshme për garantimin e pagesës së detyrimit.

Në të gjitha rastet, administrata tatimore, ka të drejtë që, si një kreditor i interesuar, të kërkojë fillimin e proçedurave të falimentimit per tatimpaguesin qe eshte person juridik.

Neni 117

Sekuestrimi tatimor

Sekuestrim tatimor eshte mjet i sigurimit te ekzekutimit te legjislacionit tatimor me ane te te cilit administrata tatimore siguron mbledhjen e detyrueshme te borxheve tatimore. Sekuestrimi kryhet ne masen e nevojshme per te shlyer borxhin tatimor.

Sekuestrimi tatimor vendoset mbi bazen e nje urdhri te nxjerre nga kryetari i drejtorise rajonale apo i njesive te ngjashme me to, nga drejtori i pergjithshem i tatimeve ose nga drejtuesi i zyres se taksave te pushtetit vendor. Urdhri per sekuestrim i shoqeruar nga kerkesa per pagesen e borxheve tatimore dhe kostove te sekuestrimit, i dergohet te sekuestruarit ne adresen e zyres qendrore ose ne adresen e shtepise ku ai banon.

Sekuestrimi tatimor bazohet mbi vleresimin e borxhit tatimor.

Masa e sekuestrimit, hiqet ne momentin e shlyerjes se detyrimit tatimor ose ne rastet kur gjate fazes se sekuestrimit arrihet nje marrveshje e pageses me keste. Sendet e sekuestruara i kthehen tatimpaguesit.

Keshilli i ministrave miraton procedurat e administrimit se sendeve te sekuestruara.

Neni 118

Sekuestruesit dhe i sekuestruari

Sekuestruesi eshte autoriteti i administrates tatimore qe miraton sekuestrimin tatimor.

I sekuestruari eshte tatimpaguesi debitor prej te cilit duhet te mblidhet borxhi tatimor i papaguar.

I sekuestruari i siguron administrates tatimore te dhena mbi asetet dhe te ardhurat e tjera, per te lehtesuar pergatitjet e autoritetit tatimor per sekuestrimin.

Sekuestrimi ndaj aseteve te pushtetit qendror ndalohe.

Neni 119

Permbajtja e Urdherave per Sekuestrim

Urdhri per sekuestrim do te permbaje:

- shumen e borxhit tatimor;
- afatin e fundit per pagesen e borxhit tatimor;
- sendin mbi te cilin vihet sekuestro ;
- metodat per zbatimin e sekuestrimit dhe
- sqarime mbi te drejtat e ankimimit administrativ.

Nese objekt i sekuestrimit eshte paga, urdhri per sekuestrim do te permbaje emrin e personit juridik si dhe seline apo adresen e punedhenesit.

Neni 120

Zbatimi i mases se sekuestrimit

Urdhri per sekuestrim zbatohet:

1. nese borxhit tatimor te tatimpaguesit i ka kaluar afati i pageses,
2. nese administrata tatimore ka ndermarre te gjitha masat per mbledhjen e borxhit tatimor;

3. nese subjekti i sekuestrimit nuk shlyen borxhin tatimor dhe kostot e sekuestrimit edhe pas kalimit te afatit prej dhjete ditesh pas dates se marrjes se urdhrin per sekuestrim.

Sigurimi i mbledhjes se borxhit tatimor nepermjet sekuestrimit dhe shitjes se pasurise sipas ketij seksioni ze vend ne renditjen e meposhtme:

- a. sendet e lujtshme ne pronesi tatimpaguesit, duke perfshire llogarite bankare, pagesat dhe rrogat e marra, duke vijuar me
- b. sendet e palujtshme ne pronesi te tatimpaguesit.

Neni 121

Zbritja e borxhit tatimor te papaguar

Nese borxhi tatimor nuk arrihet te mblidhet edhe pas procedurave te sekuestrimit, ai zbritet si i pambledhshem kur:

1. subjekti i sekuestrimit vdes pa pasuri te lujtshme ose te palujtshme qe mund te perdoren per mbledhjen e detyrimit;

2. me kerkese te tatimpaguesit, nese ekzekutimi i mbledhjes se borxhit tatimor mund te vere ne pikepyetje kerkesat per minimumin e nevojshem jetik te sekuestruarit dhe te anetareve te familjes se tij;

3. pas kalimit te afatit te parashkrimit te te drejtes per fillimin e procedurave te masave shtrënguese.

Pika 2 te paragrafit te pare te ketij neni, zbatohet ne rastet kur despozitat ligjore apo nenligjore kane miratuara minimumin e nevojshme jetik.

Vendimi per kategorizimin e borxhit si te pambledhshem merret nga drejtori i pergjithshem i tatimeve bazuar ne propozimet me shkrim nga drejtori i drejtorise rajonale me juridiksion sipas vendbanimit ose zyres qendrore te taksapaguesit.

Per borxhet tatimore te lidhura me detyrimet tatimore qe administrohen nga njesite e pushtetit vendor, vendimi per kategorizimin e borxhit si te pambledhem merret nga kryetari i njesise se pushtetit vendor.

Neni 122

Konfiskimi

Konfiskimi tatimor eshte marrja ne menyre te pakthyeshme dhe me force e mallrave nga administrata tatimore.

Administrata tatimore konfiskon::

- 1- mallrat qe ruhen, tregtohen, perdoren apo transportohen pa dokument shoqerues;
- 2- sendeve mbi te cilat ishte vendosur sekuestro, ne rast te mosshlyerjes se detyrimit tatimor nga ana e tatimpaguesit.

Konfiskimi ekzekutohet nga policia tatimore per tatimpaguesit e regjistruar prane administrates tatimore qendrore ose policia bashkiake per tatimpaguesit e klasifikuar si biznes i vogel.

Neni 123

Ankandi publik i sendeve te konfiskuara

Urdhri per konfiskim vendoset ne ekzekutim nepermjet shitjes se sendeve te sekuestruara. Sendet e konfiskuara shiten me ankand publik, sipas rregullave te parashikuara ne legjislacionin perkates.

Seksioni IV
Dispozita te tjera
per mbledhjen e detyrimeve tatimore

Neni 124
Sendet mbi te cilat nuk mund te vihet sekuestro

Sendet mbi te cilat nuk mund te vihet sekuestro, percaktohen sipas dispozitave te Kodit te Procedures Civile.

Neni 125
Te drejttat e paleve te treta

Nese i sekuestruari deklaron se prona e inventarizuar per sekuestrim zoterohet nga nje pale e trete dhe as i sekuestruari e as pala e trete nuk siguron prova per te mbeshtetur kete deklarate, sekuestruesi mund te inventarizojte keto sende dhe pala e trete udhezohet te depozitohet padine per te vertetuar te drejttat e prones, brenda dhjete diteve pas marrjes se njoftimit per inventar. Nese nuk sigurohet asnje dokument qe nje kerkese-padi e tille u regjistrua ne gjykate, sekuestrimi do te vazhdoje sikur nuk ka pasur asnje kundershtrim.

Sapo kerkese-padia regjistrohet ne gjykate brenda periudhes te specifikuar ne paragrafin e pare, shitja e prones se inventarizuar, nderpritet deri ne perfundimin e procedurave gjyqesore.

Neni 126
Inventari i pasurise se sekuestruar

Sekuestruesi harton listen e inventarit dhe raport mbi inventarin e pasurive ne te cilin perfshihen te gjitha te dhenat e nevojshme dhe hollesi te tjera qe kane ndodhur gjate inventarit. Raporti do te perfshije urdhrin qe heq te drejten per te perdorur lirisht pronen e sekuestruar.

Raporti i inventarit do te firmoset nga sekuestruesi, i sekuestruari, perfaqesuesi ligjor i tij ose nje anetar ne moshe madhore te familjes se tij/saj, deshmitaret qe marrin pjese ne te, dhe zyrtare te tjere te pranishem gjate inventarit.

Nese i sekuestruari nuk ishte i pranishem gjate inventarit, ose ai/ajo refuzon te firmose raportin, arsyet e ketij refuzimi do te perfshihen ne kete raport.

Neni 127
Kostot e sekuestrimit

Kostot e sekuestrimit perballohen nga i sekuestruari . Nese ekzistojne disa te sekuestruar, ato do te konsiderohen si debitore solidare.

Kostot e sekuestrimit miratohen me urdher te vecante brenda nje periudhe prej dhjete ditesh nga perfundimi i procesit te sekuestrimit.

Kostoja e sekuestrimit mblidhet gjate procedurave te sekuestrimit.

Neni 128
Parashkrimi i te drejtes per
fillimin e procedurave te masave shtrënguese

E drejta per fillimin e procedurat te masave shtrënguese sipas këtij ligji parashkruhet brenda 5 viteve prej ditës që duhej të paguhej tatimi i papaguar.

Afati kohor në paragrafin e pare të këtij neni pezullohet nga:

- a. kohëzgjatja e çdo apelimi kundër detyrimit në fjalë.
- b. kohëzgjatja e çdo periudhe gjatë të cilës detyrimi në fjalë i nënshtrohet investigimit zyrtar nga DPT-ja, dhe
- c. kohëzgjatja e çdo periudhe gjatë të cilës detyrimi në fjalë i nënshtrohet ndjekjes penale.

Veprimet e kundraligjshme që perbejne veper penale parashkruhen, sipas parashikimeve te kodit procedural penal.

Seksioni VI

Transferimi i detyrimit dhe borxhit tatimor

Neni 129

Detyrime për personin të cilit i kalohet pasuria

Në rastet kur borxhi tatimor nuk shlyhet plotësisht pas shitjes së pasurisë së sekuestruar, personi që ka marrë pasuri të një tatimpaguesi në një transaksion të ndodhur pas njoftimit për bllokim ose sekuestrim, pergjigjet në rradhe te dyte për detyrimet e tatimpaguesit në shumën e vlerës së pasurisë së marrë, ose deri ne vleren e shumes së paguar nga personi për ate pasuri.

Neni 130

Mosmbajtja e shumes se detyrimit nga agjentet e mbajtjes se tatimit

Nese agjentët për mbajtjen e tatimit, nuk kane respektuar detyrimin per mbajtjen ne burim te tatimit, pergjigjen per shlyerjen e tatimit, takses apo kontributit te vleresuar, kamatë-vonesës dhe gjobave.

Neni 131

Transferimi i detyrimit dhe borxhit tatimor te personit te vdekur

Detyrimi dhe borxhi tatimor i personit te vdekur, nuk përfundon me vdekjen e personit, por transferohet bashke me transferimin e te drejtave te pasurise ne përputhje me dispozitat e Kodit Civil. Per mbledhjen e tij zbatohen dispozitat e ketij ligji.

Neni 132

Transferimi i detyrimit dhe borxhit tatimor te tatimpaguesit shoqeri tregtare

Detyrimi tatimor apo borxhi tatimor i personit juridik ne likuidim nuk përfundon me venien ne likuidim te personit juridik. Likuidatori eshte pergjegjes per llogaritjen dhe pagesen e detyrimit tatimor dhe te borxhit tatimor perkates.

Administrata tatimore mund te kerroje fillimin e procedurave te falimentimit per personat juridik qe nuk kane shlyer detyrimet tatimore.

Nëse edhe pas perfundimit se procedurave te likujdimit apo falimentimit personi juridik, nuk arrin të shlyej teresisht apo plotësisht detyrimet apo borxhet e tij tatimore, detyrimi tatimor apo borxhi tatimor i ndahet secilit prej ortakeve apo aksionereve te personit juridik te likujduar, ne raport te njejte me raportin e pjesmarrjes se tyre ne kapitalin e shoqerise.

Per mbledhjen e detyrimit tatimor apo borxhit tatimor te ndare, ndiqen te njejtat procedura te parashikuara ne kete ligj.

Neni 133
Shitja dhe falja e borxhit tatimor

Keshilli i Ministrave me propozim te ministrit te financave mund te vendose te shese pjese ose te gjithë borxhin tatimor.

Keshilli i ministrave miraton rregulla ne lidhje me kriteret dhe kushtet e shitjes se borxhit tatimor.

Falja e detyrimit dhe e borxhit tatimor behet me ligj te veçante.

KREU VIII
PROCEDURAT E SHQYRTIMIT ADMINISTRATIV TE VENDIMEVE TE
ADMINISTRATES TATIMORE

Seksioni I
Procedurat e rishikimi administrativ

Neni 134
Rishikimi administrativ

Tatimpagues mund të kërkojë:

- 1- rishikim administrativ te procedures se ndjekur nga administrata tatimore per nxjerrjen e nje akti te lidhur me kontrollin tatimor, apo gjobe si dhe
- 2- verifikimin e zbatimit nga nëpunësit e administratës tatimore, te kodit të sjelljes te miratuar nga drejtori i pergjithshem i tatimeve.

Kërkesa për rishikim bëhet me shkrim dhe sipas formatit të miratuar nga drejtori i pergjithshem i tatimeve.

Kërkesa për rishikim i drejtohet drejtorise teknike te DPT-së, brenda 25 ditëve kalendarike nga dita e nxjerrjes se aktit apo kryerjes së veprimit, me të cilin ka lidhje rishikimi.

Neni 135
Kompetenca per rishikimin administrativ

Drejtuesi i drejtorise teknike ka te drejte qe pasi të shqyrtoje kerkesen per rishikim:

- a. te rekomandojë nëse duhet të merret masë disiplinore apo të behet kallzim per ndjekje penale ndaj një nëpunësi të administratës tatimore; dhe
- b. të vendose zhdëmtimin e tatimpaguesit nëse ai si pasojë e veprimeve të paligjshme të administratës tatimore, ka pesuar humbje financiare të dokumentuara.

Tatimpaguesi ka të drejtë të paraqitet personalisht për të shpjeguar çështjet në të gjitha seancat e rishikimit dhe të marrë kopje te vendimeve dhe proces-verbaleve.

Neni 136
Procedurat e rishikimit administrativ

Drejtuesi i drejtorise teknike brenda 30 diteve nga marrja e kërkesës për rishikim formal, merr vendim me shkrim. Nje kopje te vendimit ja dërgon drejtorit te pergjithshem te tatimeve dhe nje tjetër e depoziton në dosjen e tatimpaguesit.

Vendimi mund te perfshije edhe rekomandim per masat disiplinore qe duhen marre ndaj nëpunësit e administratës tatimore qe ka shkelur ligjet, procedurat administrative apo kodin e sjelljes.

Vendimi ne lidhje me masat disiplinore merret ne perputhje me dispozitat e ketij ligji.

Nëse vendimi nuk lëshohet brenda afatit, apo nëse tatimpaguesi nuk është i kënaqur me vendimin, ai brenda 10 ditëve nga përfundimi i periudhës 30 ditore apo datës së marrjes së shkresës së vendimit apo dërgimit të vendimit në dosjen e tatimpaguesit, mund të bëjë një kërkesë për fillimin e procedurave disiplinore, tek drejtoria e apelimeve tatimore.

Seksioni II

Apelimi i akteve administrative te vleresimeve tatimore

Neni 137

Vendimet administrative te apelueshme

Tatimpaguesi mund apeloje prane drejtorise se apelimit tatimor kundër:

- çdo vlerësimi tatimor te nxjerre nga kontrolli tatimor te kryer nga administrata tatimore;
- dënimi me gjobe
- vleresimi te gabuar te shumes interesit.

Apelimi bëhet me shkrim, brenda 37 ditëve të dërgimit te aktit administrativ ne lidhje me vleresimin tatimor apo vleresimin e ri tatimor, dhe sipas formatit të miratuar nga drejtori i pergjithshem i tatimeve. Nje kopje e ankimit depozitohet edhe ne organin tatimor i cili ka miratuar aktin administrativ objekt te ankimit.

Neni 138

Detyrimi per pagesen e tatimit, takses apo kontributit te vleresuar perpara depozitimit te apelimit

Tatimpaguesi, bashke me kerkesen per apelimin depoziton dokumentin qe verteton pagesen e shumes se tatimit, takses apo kontributit te vleresuar.

Akt administrativ i leshuar nga administrata tatimore e per te cilin nuk jane ndjekur te gjitha shkallet e apelimit administrativ brenda strukturave te drejtorise se pergjithshme te tatimeve nuk mund te ankimohet ne rruge gjyqesore.

Tatimpaguesi bashke me kerkese-padine depoziton edhe dokumentin qe verteton pagesen e 15% te shumes se gjobes.

Perllogaritja dhe shlyerja e kamatvoneses ne lidhje me shumen e gjobes behet ne ditën e pageses se detyrimit.

Shqyrtimi gjyqesor i kerkese-padive te lidhura me detyrime tatimore, zhvillohet sipas nje procedure te persheptuar, e cila nuk duhet te kaloje 60 dite.

Neni 139

Kompetenca për shqyrtimin e apelimit

Drejtori i apelimit tatimor ka te drejte qe me nje vendim me shkrim, të lere te pandryshuar, te ndryshoje apo shfuqizojë vlerësimin për të cilin është bërë apelim.

Gjate shqyrtimit te ankeses drejtoria e apelimit tatimor ka te drejte te kerkoje cdo informacion shtese nga strukturat e administrates tatimore para se të shqyrtoje ankesen apo të marrë vendimin për apelimin e bere.

Tatimpaguesi ka të drejtë të paraqitet për të ofruar prova dhe shpjegime për të mbështetur apelimin e tij si dhe per të mbajë shënime per veprimet e kryera.

Kopje te vendimit te dejtorit te drejtorise se apelimit tatimor i dërgohen tatimpaguesit, organit tatimor qe ka miratuar aktin adminitrativ objekt i ankimimit, si dhe depozitohen në dosjen e tatimpaguesit.

Barra e proves për të vërtetuar se vlerësimi është i pasaktë i përket tatimpaguesit.

Neni 140

Afati dhe permbajtja e vendimit

Vendimi merret brenda 30 diteve nga data që apelimi është depozituar në drejtorinë e pergjithshem te tatimeve dhe duhet të permbaje referencat ligjore, te citoje dispozitat ligjore si dhe te shpjegoje menyren e perdorur per perllogaritjen e detyrimit.

Nëse drejtori i drejtorise se apelimit tatimor, nuk merr vendim brenda afatit te parashikuara ne paragrafin e pare te ketij neni, tatimpaguesi brenda 30 diteve nga perfundimi i atij afati, mund te ankohet ne rruge gjyqesore.

Per rivendosjen ne afat, zbatohen dispozitat e kodit te procedurave administrative.

KREU IX

SENKSIONET

Seksioni I

Kundervajtjet administrative te kryera nga tatimpaguesit

Neni 141

Kundervajtje tatimore

Kundervajtje tatimore konsiderohet çdo veprim apo mosveprim i tatimpaguesit, agjentit tatimor, apo përfaqësuesit te tatimpaguesit, i cili është kundeshitim me legjislacionin tatimor.

Neni 142

Mungesa e ekzekutimit te detyrimit per regjistrim

Mosrespektimi i detyrimit per regjistrim dënohet me gjobë te barabarte me 75.000 lek.

Mosrespektimi i detyrimit per perditesimin e te dhenave te rregjistrave dënohet me gjobë te barabarte me 50.000 lek.

Neni 143

Mos-deklarimi në afat

Tatimpaguesi i cili nuk leshon deklaraten tatimore në afat dënohet me gjobë të barabartë me 10.000 lek .

Neni 144

Mos-deklarimi i punonjësve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore

Punëdhënësi i cili nuk deklaron numrin e sakte të punonjësve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, detyrohet të paguajë, përveç shumës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të papaguara, edhe një gjobë të barabartë me 10.000 dhjetë mijë lekë për çdo punonjës të pa deklaruar.

Neni 145

Mos-pagimi në afat të tatimit, takses apo kontributit të vlerësuar

Tatimpaguesi i cili nuk arrin që brenda afatit të parashikuar në këtë ligj për pagesë të paguajë, shumën e tatimit, takses, kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë të barabartë me 5 % të shumës së detyrimit të papaguar për secilin muaj apo pjesë të muajit që nuk është lëshuar deklarata. Në asnjë rast shuma nuk mund të jetë më e vogël se 10.000 lekë dhe më e madhe se 25 % të detyrimit të paguar.

Neni 146

Deklarimi i pasakte dhe kërkesa e pasakte

Dorëzimi i një deklarate tatimore të pasakte apo kërkesë të pasakte për rimbursim gjobitë me një gjobë të barabartë me 5 % e detyrimit të papaguar apo rimbursimit të kërkuar me tepër, për secilin muaj apo pjesë muaji derisa shuma e detyrimit të paguhet plotësisht. Në asnjë rast shuma nuk mund të jetë më e vogël se 10.000 lekë dhe më e madhe se 25 % të detyrimit të paguar.

Neni 147

Dorëzimi i dokumentave false

Dorëzimi i dokumentave false, deklaratave të pavërtetëta apo informacioneve joreale, konsiderimi i të cilave i cili çon në përlogaritjen e pasakte të shumës së tatimit, takses apo kontributit, denohet me gjobë të barabartë me 50% të diferencës së shumës së përlogaritur nga ajo që duhet të ishte llogaritur në fakt.

Neni 148

Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim

Çdo agjent i mbajtjes së tatimit në burim që nuk arrin të mbledhë tatimin në fjalë apo të japë llogari për të apo ta paguajë tatimin e tillë në datën e caktuar apo t'i shmanget pagesës së tij, detyrohet të paguajë një gjobë të barabartë me 50 % të shumën e plotë të tatimit të pambledhur, të papaguar apo të shmangur.

Neni 149

Mos-mbajtja e saktë e librave, regjistrave dhe dokumentacionit

Tatimpagues që nuk arrin të mbajë regjistrat dhe dokumentacionin tatimor të kërkuar sipas këtij ligji, detyrohet të paguajë një gjobë të barabartë me 50.000 lekë.

Neni 150

Mallrat e pashoqëruar me dokumenta tatimore

Tatimpaguesi qe mban ne ruajte, përdor apo transporton mallra te pashoqeruar me dokumenta tatimore ne perputhje me dispozitat e ketij ligji, denohet me konfiskimin e mallrave.

Neni 151 **Kundervajtjet ne perdorimin e pajisjeve fiskale**

Tatimpaguesi person juridik denohet me gjobe nga 20.000 deri ne 100.000 leke nese:

1. nuk instaloje dhe përdorë paisjen fiskale për regjistrimin e pagesave me para në dorë;
2. nuk leshon kupon tatimor për qarkullimin e realizuar të mallrave, apo shërbimet;
3. leshon nje bilete që nuk përmban elementët e përcaktuar ne kete ligj per kuponin tatimor;
4. leshon kupon tatimor ne te cilin ka vendosur nje vlere te ndryshme nga vlere e çmimit te afishuar;
5. nuk afishon në një vend të dukshëm një poster për detyrimin e blerësit të mallrave, apo përfituesit të shërbimit për të kërkuar kupon tatimor;
6. nuk mban kontrollin e gjurmës së kuponit tatimor ne ambientin e ofrimit te mallrave apo shërbimeve;
7. nuk ben faturë për qarkullimin e mallrave të realizuar, apo. shërbimeve te ofruara;
8. nuk mban libër llogarie për qarkullimin e kryer të mallrave;
9. nuk merr me qera apo nuk regjistron paisje fiskale rezervë ne rastet kur ky ligj parashikon kete detyrim;
10. nuk mban dhe mirëmban ne kushte pune paisjet fiskale.
11. nuk njofton menjehere defektin e ndodhur ne pajisjen fiskale dhe nuk ploteson ne rregull librezin fiskale te defekteve.

Për kundravajtjet e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni, drejtori përgjegjës i tatimpaguesit, denohet me gjobe nga 10.000 deri ne _30.000 leke.

Per kundervajtjet e parashikuara ne paragrafin e pare te ketij neni, te kryera me shume se nje here, mund te vendoset pezullimi i veprimtarise deri ne tre muaj.

Per kundervajtjet e parashikuara ne paragrafin e pare te ketij neni, te kryera me shume se tre here, mund te vendoset mbyllja e veprimtarise.

Konstatimi, shqyrtimi dhe dënimi i shkeljeve të parashikuara në këte nen bëhet nga organet tatimore dhe të policisë financiare të juridiksionit ku tatimpaguesi ushtron veprimtarinë ose kryen shkeljet.

Neni 152 **Kundervajtjet ne leshimin e faturave tatimore**

Mosleshimi i fatures tatimore apo fatures tatimore ose faturës tatimore me TVSH, denohet me gjobe te barabarte me 50% të detyrimit tatimor të padeklaruar ose të papaguar si rezultat i moslëshimit të faturës, përveç detyrimeve tatimore dhe interesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe ligjeve specifike tatimore.

Neni 153 **Mospamarrja e kuponit tatimor**

Individi blerës, ose individi përfitues i shërbimit i cili gjate kontrollit ne disnancat e parashikuara ne kete ligj nga vendi i shitjes apo ofrimit te shërbimit, nuk gjendet i pajisur me kupon tatimor, denohet me gjobe te barabarte me 1.000 lek.

Konstatimi, shqyrtimi dhe dënimi i shkeljes së parashikuara në këte nen bëhet nga organet policisë tatimore të juridiksionit ku kryen shkeljet.

Neni 154

Mosdhënia e informacionit

Refuzimi per dhenien e informacionit te kerkuar nga administratës tatimore ne perputhje me dispozitat e ketij ligji denohet me gjobe te barabarte me 200.000 lek.

Neni 155

Pengimi i kontrollit tatimor

Tatimpagues i cili në mënyrë të drejtpërdrejt apo të tërthortë, pengon ushtrimin e te drejtave te administrates tatimore ne lidhje me kontrollin tatimor, denohet me nje gjobe e cila eshte me e madhja ne vlere ndermjet 500.000 lek.

Te drejten per miratimin e mases se gjobes se parashikuar ne paragrafin e pare te ketij neni e ka drejtori i drejtorise rajonale apo i njesive te ngjashme me to si dhe per tatimpaguesit e klasifikuar si biznes i vogel kjo e drejte i takon kryetarit te zyres se tatim-taksave.

Neni 156

Leshimi i fatures se pasakte

Tatimpaguesi që lëshon fature tatimore të pasaktë e që rezulton me ulje të detyrimit, apo rritje të shumës per t'u rimbursuar denohet me gjobe te barabarte me 50 % të shumës së efektit në ulje të detyrimit tatimor, përveç detyrimeve tatimore dhe interesave të llogaritura në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të ligjeve specifike tatimore.

Tatimpaguesi që lëshon një faturë tatimore me pasaktësi por që provohet se nuk ka efekt në llogaritjen dhe pagimin e detyrimit tatimor dënohet me gjobë prej 10.000 lekë.

Tatimpaguesi i cili nuk është subjekt i detyrimit per leshimin e fatures me TVSH, dhe lëshon fatura TVSH-je, dënohet me gjobe te barabarte me 50% TVSH-së së dhënë në faturën tatimore të paautorizuar.

Neni 157

Dënimet për tatimpaguesit qe jane banka

Banka qe hapjen e një marrëveshje (shlyerje) dhe llogarive të tjera të një personi fizik dhe juridik, pa paraqitjen e dokumentacionit zyrtar që konfirmon nipt-in e tatimpaguesit, denohet me gjobe te barabarte me 50.000 lek.

Banka qe nuk respekton afatet për njoftimin e administratës tatimore për hapjen e marrëveshje (shlyerje) dhe llogarive të tjera nga tatimpaguesi, denohet me gjobe te barabarte me 40.000 lek.

Nëse vendimi i posaçëm i lëshuar në përputhje me paragrafin e dyte nenit 115 te ketij ligji nuk zbatohet brenda 7 diteve nga data e lëshimit, banka ose debitori te cilit i

eshte derguar vendimi, është subjekt i një gjobe prej 0.04 % të detyrimit për t'u paguar, për çdo ditë që vazhdon moszbatimi.

Neni 158
Mosafishimi i çmimeve te shitjes

Mosafishimi i çmimeve te shitjes se mallrave apo sherbimeve, denohet me gjobe te barabarte me 35.000 lek per tatimpaguesit e klasifikuar si biznes i vogel dhe 65.000 lek per tatimpaguesit e tjere.

Seksioni II
Kundervajtjet administrative dhe vepra penale te kryera
nga nepunesit dhe drejtuesit e administrates tatimore

Neni 159
Transferimi i borxhit tatimor
te pambledhur per faj te nepunesit tatimor

Ne rast se afati i te drejtes per fillimin e procedurave te masave shtrenguese eshte parashkruar dhe administrata tatimore nuk ka respektuar afatet dhe dispozitat ligjore per mbledhjen e borxhit tatimor, te gjithë drejtuesit qe kane patur per detyre te fillonin procedurat e mbledhjes se borxhit, denohen me gjobe me shuma te barazvlefshme me pese deri ne dhjete paga mujore. Masat per kundervajtjet administratime miratohen me urdher te drejtorit te pergjithshem.

Neni 160
Mosrespekti i procedurave te vleresimit tatimor

Mosrespektimi nga nepunesi tatimor i procedurave te parashikuara nga ky ligj ne lidhje me kompetencen, afatet dhe dokumentimin e akteve si dhe permbajtjen e akteve te lidhura me vleresimin tatimor, denohet me gjobe te barabarte me 20.000 lek.

Neni 161
Perllogaritja e gabuar e shumes detyrimit

Perllogaritja e gabuar e detyrimit tatimor te bere gjate kontrollit tatimor, qe rezulton nga rikontrolli tatimor i urdheruar ne rastet kur ka pasur arsye te besohet se gjate kontrollit te meparshem grupi i kontrollit ne perllogaritjen e detyrimit tatimor ka vepruar ne kundërshtim me ligjin, perben veper penale dhe, secili nga inspektoret tatimor, denohen me gjobe te barabarte me 30 % te shumes se detyrimit te zbritur apo te shtuar.

Neni 162
Mosrespektimi i procedurave te kontrollit tatimor

Mosrespektimi nga nepunesi tatimor i procedurave te parashikuara nga ky ligj ne lidhje me kompetencen, afatet dhe dokumentimin e akteve si dhe permbajtjen e akteve te lidhura me kontrollin tatimor, denohet me gjobe te barabarte me 50.000 lek.

I njëjti veprim kur ka sjelle si pasoje deklarimin e pavlefshem të kontrollit perben veper penale dhe denohet me gjobe të barabarte me detyrimin tatimor që duhet të paguante tatimpaguesi.

Neni 163 **Ndjekja e dyfishtë**

Vendosja e çfarëdolloj dënimi administrativ nuk e ndalon administratën tatimore për të bere kallzim penal kundër tatimpaguesit kur shkelja perben edhe veper penale.

Rezultati i çfarëdolloj kallzimi penal nuk e pezullon apo pengon të drejten e administrates tatimore të vendose dhe ekzekutoje masat e dënimit administrativ mbi të njëjtin tatimpagues ndaj të cilit mund të kete filluar ndjekja penale.

KREU X **DISPOZITA TRANZITORE DHE TE FUNDIT**

Neni 164 **Efekti në detyrimet tatimore dhe vlerësimet ekzistuese**

Kontrollet, e nisura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përfundojnë brenda 15 diteve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit dhe për ndjekjen e procedurave të ankimimit apo vlerësimit, i nënshtrohen dispozitave të këtij ligji.

Detyrimet tatimore dhe gjobat e tjera të vendosura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, kontabilizohen si borxh tatimor dhe mblidhen në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë ligj.

Vlerësimet e nisura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përfundojnë brenda 30 diteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe për ndjekjen e procedurave të ankimimit administrativ i nënshtrohen dispozitave të këtij Ligji.

Neni 165 **Komisioni i apelimeve tatimore**

Brenda 30 diteve nga miratimi i këtij ligji, përfundojnë të gjitha funksionet e komisionit të apelimeve tatimore.

Pas dates së miratimit të këtij ligji në kuvend, komisioni i apelimeve tatimore nuk do të pranojë me depozitimin për shqyrtim të kërkesave të reja.

Komisioni i apelimeve tatimore shqyrton të gjitha praktikat e depozituara në sekretarinë e komisionit brenda afatit të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni.

Neni 166 **Afati për futjen në përdorin të pajisjeve fiskale**

Përdorimi i pajisjes fiskale, në përputhje me kërkesat e këtij ligji do të përfundojë në _____ .

Neni 167 **Manuali i zbatimit të ligjit të procedurave tatimore**

Ministri i Financave miraton udhezimin e zbatimit te procedurave tatimore ne Republiken e Shqiperise. Udhezimi publikohet edhe ne buletin tatimor dhe eshte i detyrueshem per administraten tatimore dhe tatimpaguesit.

Drejtori i pergjithshem i tatimeve, pervec akteve te tjera te parashikuara ne kete ligj, miraton manualet teknike, manualin e vleresimit, kontrollit, investigimit, te sherbimit te tatimpaguesi dhe te masave shtrenguese.

Buletini tatimor eshte publikimi zyrtar i drejtorise se pergjithshme te tatimeve.

Neni 168 Shfuqizime

Me hyrjen ne fuqi te ketij ligji, Ligji nr. 8560, datë, 22.12.1999 “Mbi Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe aktet nenligjore te nxjerra ne zbatim te tij shfuqizohen.

Me hyrjen ne fuqi te ketij ligji, ligji nr. 7758, date 12.10.1993 “Mbi dokumentmin dhe mbajtjen e llogarive per tatimet” si dhe aktet nenligjore te nxjerra ne zbatim te tij, shfuqizohen.

Me hyrjen ne fuqi te ketij ligji dispozitat e nenit

1-

2-

3-

4-

(x) shfuqizohen

Neni 169 Hyrja në fuqi

Ky Ligj hyn në fuqi ne date _____ .

JOZEFINA TOPALLI

KRYETARE E KUVENDIT